



Address: Str. Regjep Mala, No. 27, Aktash I, Prishtina, Kosova
Tel: +381 38 249 320, Fax: +381 38 249 321, [Http://www.riinvestinstitute.org](http://www.riinvestinstitute.org)

*PROMOVIMI I ZHVILLIMIT EKONOMIK NËPËRMES SHOQËRISË
CIVILE, Faza II (2002-2004)*

SISTEMI I ARSIMIT DHE ZHVILLIMI EKONOMIK I KOSOVËS

(Raport hulumtues)

Shkurt 2004

Ky raport është përgaditur si pjesë e projektit 'Promovimi i Zhvillimit Ekonomik Nëpërmjet Shoqërisë Civile', Faza e II, i cili realizohet nga Instituti Riinvest me mbështetjetjen e Agjencionit të Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) Misioni në Kosovë..

Ekipi i projektit:

Isa Mustafa, Kordinator i projektit
Avdullah Hoti, Menaxher i projektit
Petrir Gashi
Venera Demukaj
Ymer Havolli
Mrika Kotorri
Besnik Berisha
Afërdita Berisha

Konsultant:

Profesor Nick Adnett, Staffordshire University
Profesor Marek Kweik, Poznan University, Poloni

Riinvesti dëshron të falenderoj këta persona për kontributin e dhënë në një takim konsultativ në tetor 2003, ku është diskutuar koncepti dhe plani i aktiviteteve për realizimin e këtij hulumtimi: Michael Martin (USAID), Luan Gashi (USAID), Dukagjin Pupovci (KEC), Jonuz Salihaj (KEC), Halim Hyseni (KEC), Muhamet Bicaj (UP), Luljeta Demjaha (MASHT), Shefqet Sylejmani (MPMS), Hafiz Leka (MPMS), Selman Selmanaj (UP).

PËRMBAJTJA

Lista e tabelave, figurave dhe bokseve.....	4
Shkurtesat.....	5
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	6
REKOMANDIMET – POLITIKAT QË DUHET ZBATUAR	10
1. HYRJJE.....	14
2. ARSIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK I KOSOVËS	16
2.1 Arsimit dhe Performansat Ekonomike	16
2.2 Prioritetet aktualte të politikave në BE dhe OECD	17
2.3 Arsimit dhe Zhvillimi Ekonomik në Kosovë.....	19
2.3.1 Rëndësia e Arsimit për Kosovën.....	19
2.3.2 Shpenzimet Qeveritare në Arsimit	21
2.3.3 Qeverisja dhe Legjislacioni.....	23
2.3.3.1 Arsimit i mesëm – qeverisja dhe legjislacioni	23
2.3.3.2 Arsimit i lartë – qeverisja dhe legjislacioni	24
3. ARSIMI I MESËM DHE I LARTË NË KOSOVË: SITUATA AKTUALE DHE	
VLERËSIMI.....	25
3.1 Struktura aktuale e shkollimit – Struktura e re organizative.....	25
3.2 Vlerësim mbi gjendjen në sistemin e arsimit: Anketat e Riinvestit.....	28
3.2.1 Objektivat dhe metodologjia e hulumtimit	28
3.2.2 Rezultatet e hulumtimit: Arsimit i Mesëm.....	32
3.2.3 Rezultatet e hulumtimit: Arsimit i Lartë	36
4. QËSHTJET KYQE NË FORCIMIN E ROLIT TË ARSIMIT NË ZHVILLIMIN	
EKONOMIK	42
4.1 Qeverisja dhe legjislacioni.....	42
4.2 Matja e outputeve dhe menaxhimi i bazuar në performansa	43
4.3 Financimi	43
4.4 Decentralizimi në arsimin e mesëm.....	44
4.5 Vlerësimi/testimi i jashtëm i bazuar në kurrikule	44
4.6 Udhëzimet për karrierë	45
4.7 Reforma në Universitet.....	46
REFERENCAT.....	49
ANEKSET E TË DHËNAVE	51
ANEKSI A: Të dhënat mbi arsimin në disa vende në tranzicion dhe në Kosovë	51
ANEKSI B: Përmbledhje e rezultateve nga anketa me mësimdhënës universitar.....	53
ANEKSI C: Përmbledhje e rezultateve nga anketa me mësimdhënës të shkollave të mesme ...	56
ANEKSI D: Përmbledhje e rezultateve nga anketa me studentë universitar.....	58

Lista e tabelave, figurave dhe bokseve

Tabela 1: Niveli i arsimit të popullsisë në Kosovë (grupmosha 25-64)	20
Tabela 2: Shpenzimet për arsim si përqindje e BPV-së	21
Tabela 3: Shpenzimet e Qeverisë për Arsim në Kosovë 2000-2004, (në '000 Euro).....	21
Tabela 4: Shpërndarja e fondeve për arsim për paga, mallra, shërbime dhe konsum kapital	22
Tabela 5: Punësimi në arsim	22
Tabela 6: Struktura e re e sistemit arsimor në Kosovë (MASHT)	25
Tabela 7: Numri i studentëve në UP (2002/2003) dhe numri i studentëve të diplomuar (1991-2002).....	27
Tabela 8: Popullacioni dhe mostra e shkollave të mesme të përfshirë në hulumtim	29
Tabela 9: Mostra e mësimdhënësve universitar	30
Tabela 10: Shpërndarja e mostrës në anketën me studentë	31
Tabela 11: Disa rezultate kryesore nga intervista me Drejtorët e Shkollave të Mesme	32
Tabela 12: Numri i nxënësve për një kompjuter	34
Tabela 13: Të dhëna mbi numrin e të diplomuarve në Universitetin e Prishtinës (1970/71 deri 2001/2002)	36
Tabela 14: Vendbanimi permanent i studentëve të anketuar	36
Tabela 15: Opinonet e mësimdhënësve dhe studentëve në lidhje me disponueshmërinë me literaturë	39

Figura 1: A) Pjesëmarrja në arsimin e lartë (krahasime në nivel ndërkombëtar); dhe B) Numri i studentëve për 100,000 banorë në EJK (2000).....

Figura 2: Struktura moshore e mësimdhënësve universitar.....

Boksi 1: Benefitet ekonomike dhe shoqërore për individët dhe shoqërinë nga arsimimi i lartë.....	16
Boksi 2: Definimi i sudimet me korespondencë në Ligjin e Arsimit të Lartë.....	24
Boksi 3: Shkollat po orientohen gjithmonë e më shumë ndaj tregut.....	33
Boksi 4: Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim (EPIP).....	35
Boksi 5: Zhvillimi i kurrikuleve për biznes dhe ekonomiks në UP (2001-2004).....	37
Boksi 6: Institucionet private të arsimit të lartë: Kolegji Arteve dhe i Shkencave Sociale.....	41
Boksi 7: Institucionet private të arsimit të lartë: Universiteti Amerikan i Kosovës	41

Shkurtesat

AER	Agjensioni Evropian për Rikonstruktim.
UAK	Universiteti Amerikan i Kosovës
EQL	Evropa Qëndrore dhe Lindore
DASHT	Departamenti i Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
UE	Unioni Evropian
IJD	Investimet e jashtme direkte
PPPA	Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim
BPV	Bruto Produkti Vendor
ONM	Organizata Ndërkombëtare e Migrimit
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
QAK	Qendra për Arsim e Kosovës
ZPK	Zyra Pedagogjike e Kosovës
AKM	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
LASH	Lidhje e Arsimitarëve Shqiptar
ATP	Anketa me Tregun e Punës
TP	Tregu i Punës
LAFM	Ligji mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MASHT	Ministrie e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
OJQ	Organizatë jo Qeveritare
OBEXH	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (në anglisht OECD)
RIT	Instituti Roçester për Teknologji
EJL	Evropa Juglindore
ESK	Enti i Statistikës të Kosovës
PSSGJ	Përfaqësuesi Special I Sekretarit Gjeneral
SHM	Shkollat e Mesme
SM	Sindikata e Mësimdhënësve
SNKA	Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit
UNMIK	Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Pashkuara në Kosovë
UP	Universiteti i Prishtinës
USAID	Agjencioni i SHBA-ve për Zhvillim Ndërkombëtar

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

- 1. Objektivat e raportit:** Ky raport është përgatitur në kuadër të modulit ‘Sistemi i arsimit zhvillimi ekonomik i Kosovës’, si pjesë e projektit “*Promovimi i Zhvillimit Ekonomik nëpërmjet Shoqërisë Civile-Faza II*” që Riinvesti është duke e realizuar me mbështetjen e Zyrës së USAID-it në Prishtinë. Raporti merret kryesisht me trajtimin e sistemit arsimor të mesëm dhe të lartë. Objektivat e këtij raport janë: (i) nxitja i një debati të angazhuar mbi sistemin arsimor në Kosovë; (ii) ndërgjegjësimi i hartuesve të politikave dhe akterëve të tjerë në lidhje me rëndësinë e sistemit modern të arsimit për aftësimin e brezave të rinj të kosovarëve për t’u përfshirë gjëresisht në progresin ekonomik; dhe (iii) bazuar në hulumtimet dhe analizën e situatës së tanishme, eksperiencat relevante të vendet e tjera dhe sfidat e së ardhmes, të rekomandohen politika të përshtatshme për vënjen e themeleve të duhuara për një sistem arsimor efikas e që mundëson zhvillimin më të shpejtë ekonomik.
- 2. Rëndësia e arsimit për Kosovën.** Gjatë viteve të fundit qeveritë e kanë konsideruar arsimin si një faktor gjithmonë e më të rëndësishëm për zhvillimin ekonomik të vendeve të tyre. Mekanizmat prapa kësaj ndërlidhjeje janë: a) produktiviteti më i madh i punës dhe b) shfrytëzimi më i shpejt i risive teknologjike. Faktori i pari nënkuton se investimet në shkollim gjenerojnë përfitime më të larta për individët në formën e të ardhurave më të mëdha dhe periudhë më të shkurtër të papunësisë dhe të mospjesëmarrjes në tregun e punës. Kapitali njerëzor i mishëruar në popullsinë kosovare është pasuria më e madhe e vendit. Prandaj qasja e barabartë në një sistem modern të arsimit është gjithashtu një faktor i rëndësishëm për promovimin e zhvillimit modern ekonomik dhe kjo është kusht i barazisë e mirëqënies sociale si dhe për ngrijen e mirëqënies së minoriteteve dhe grupeve të lëna anash (të marginalizuara). Hoti dhe Adnett (2004) tregojnë që edhe në Kosovë, në nivelin individual, niveli i shkollimit është një faktor vendimtar në rritjen e probabilitetit për të gjetur dhe mbajtur punën si dhe siguron nivel më të lartë të të ardhurave në Kosovë. Nivelet e larta të arritjeve në arsimin stimulojnë inovacionet, vetëpunësim dhe ndërmarrësinë në vend dhe në mënyrë thelbësore përshpëtojnë procesin e transferimit të njohurive. Për të gjitha këto arsye, shpenzimet në arsim duhet të shihen si investime, efekti i të cilave do të jetë parasegjithash një zhvillim më i shpejtë ekonomik. Kjo është arsyeja pse Qeveria e Kosovës duhet të caktoj si prioritet rritjen e shpenzimeve publike dhe private në arsim.
- 3. Struktura e re organizative e sistemit arsimor:** Kosova tashmë ka sistemin 5 + 4 +3 të shkollimit fillor dhe të mesëm, i cili fillon në moshën 6 vjeçare. Ndyshime e fundit strukturore janë ndërmarrë me qëllimin të krijimit të një sistemi arsimor në pajtueshmëri me sistemet arsimore në vendet e BE-së dhe të vendeve të tjera të zhvillura. Gati një e katërta e popullsisë së Kosovës janë në arsim të rregullt. Në vitin shkollor 2002/2003 në Kosovë kishin 973 shkolla fillore me 315,089 nxënës të rregjistruar dhe 20,352 mësues. Në po të njëjtin vit ka patur 140 shkolla të mesme (në 72.5% të tyre mësimi është në shqip, në 22% në serbisht, kurse në 4.5% mësohet në më shumë se një gjuhë, si dhe në një shkollë të mesme mësohet në turqisht, 0.7%). Numri total i nxënësve të rregjistruar në arsimin e mesëm në këtë ishte 86,830 (55.1% meshkuj). Universiteti i Prishtinës, me 23,175 studentë (në vitin 2002/2003), është i përbërë nga 15 fakultete dhe 7 shkolla të larta. Ndërkohë ka edhe disa ofrues private të arsimit të lartë, por ata janë ende në fazën e tyre fillestare të zhvillimit.
- 4. Vlerësim mbi sistemit arsimor – Arsimi i mesëm:** Pjesëmarrja në arsimin parashkollor është e tejet e ulët, ndërsa arsimit fillor dhe i mesëm vuan nga niveli i lartë i abstenimit (vijimit jo të rregullt) nga ana e nxënësve dhe nivel të ulët të pjesëmarrjes në të dy nivelet e arsimit që pasojnë arsimin e detyrueshëm (arsimi i mesëm i ulët dhe ai i lartë). Ka pak tregues në bazë të të cilëve do mund të mateshin performancat e shkollave. Sistemi Informatik për Menaxhimin e Arsimit deri më tani është përqendruar me të drejtë në zhvillimin e sistemeve për regjistrimin e nxënësve që janë aktualisht në shkolla si dhe në përcjelljen e tyre nëpër nivele të ndryshme të

arsimit. Duhet theksuar se të dhënat e mbledhura nuk janë përdorur ende për të marrë vendime ose për të vënë objektiva që duhet të arrihen. Ndërtesat dhe paisjet janë në gjendje të keqe. Mësimdhënësit në arsimin e mesëm zakonisht japin mësim vetëm në një lëndë dhe kjo gjë shpie drejt mungesës së fleksibilitetit. Struktura moshore e stafit mësimdhënës në arsimin e mesëm tenton të anojë drejt grupmoshës 41-50 (43% i përkasin kësaj grupmose). Numri mesatar i nxënësve për një shkollë të mesme është 932, nga të cilët mesatarisht 37% janë femra (kjo përqindje është më e lartë për gjimnazet) dhe numri mesatar i nxënësve për klasë sillet nga 26 tek 31 nxënës për klasë. Pothuajse 50% e mësimdhënësve të intervistuar në shkollat e mesme mendojnë se tekstet shkollore janë të cilësisë të dobët ose deri diku të mire. Shumica e shkollave të mesme kanë laborator kompjuterash, megjithëse numri i kompjuterave për një shkollë është i ulët dhe ndryshën nga shkolla në shkollë. Në disa shkolla ka pothuajse 228 nxënës për një kompjuter, ndërsa vetëm pak shkolla kanë internet dhe pak prej tyre e përdorin atë në mënyrë efektive. Këtë vit (2003/04) është prezantuar për herë të parë kurrikulum i klasës së 10-të, e cila do të ndiqet nga klasa e 11-të dhe 12-të. Të dhënat e anketimit tregojnë se mbi ¾ e mësuesve mendojnë se nevojiten ndryshime të mëtejshme në kurrikulum. Ka ndryshime thelbësore në shkallën e përfshirjes në shkolla midis meshkujve dhe femrat dhe midis zonave urbane dhe rurale.

5. Vlerësim mbi sistemit arsimor – Arsimi i lartë: Fakultetet dhe Shkollat e Larta të Universitetit të Prishtinës (UP) nuk kanë të dhëna mbi shkallën e diplomimit të studentëve, përsëritjen apo braktisjes së studimeve. Të dhënat nga Zyra e Qendore e Universitetit tregojnë se 2,375 studentë kanë diplomuar vitin e kaluar nga numri total prej mbi 23,000 studentësh, shifër që përbën një nivel shumë të ulët të diplomimit. Meshkujt dominojnë midis studentëve në Universitetin e Prishtinës (55% në 2002/03). Prej 375 studentëve të intervistuar vetëm 33% janë prej zonave rurale gjë që tregon për një pjesëmarrje shumë të pafavorshme në arsimin e lartë të të rinjve nga zonat rurale. Rreth 79% e stafit mësimdhënës në UP janë meshkuj, 62% kanë titullin “Doktor dhkence” dhe 33% titullin “Magjistër i shkencave”. Ligjëruesit meshkuj kanë zakonisht kualifikime më të larta se ligjëruesit të gjinisë femrore. Përmisimi i kurrikulës është renditur si prioriteti kryesor nga ligjëruesit kur këta u pyetën lidhur me rekomandimet e tyre për përmisimin e mësimdhënies në UP. Megjithëse gati shumica e fakulteteve të UP-së kanë biblioteka, ligjëruesit dhe studentët nuk e konsiderojnë fondin me libra të këtyre bibliotekave si të mjaftueshëm. Të gjithë fakultet kanë mungesë të teknologjisë informative (IT-së). Shumica e fakulteteve kanë internet, por duke patur parasysh numrin e vogël të kompjuterave, shumë pak studentë mund të kenë qasje ose e përdorin atë. Profesorët e Universitetit i shprehen se ka nevojë për ndryshime shtesë në kurrikulum (84% e tyre i shohin ndryshimet e mëtejme si të nevojshme). Ndonëse është e vështirë të përcaktohet qartë se deri në ç’masë UP-ja po i përgatit studentët për tregun e punës, nga anketat me NVM private del qartë se ende ekziston një shpërpjestim i theksuar midis përgaditjeve teorike dhe dhënies së shkathësive për të mësuar dhe për të punuar.

6. Shpenzimet qeveritare në fushën e arsimit: Arsimi në Kosova është kryesisht publik. Pjesëmarrja e sektorit privat në këtë fushë është ende simbolike. Arsimi fillor dhe i mesëm financohet nga grantet e Buxhetit Qendror, të cilat transferohen tek komunat, ndërsa arsimi i lartë financohet direkt nga Buxheti i Kosovës dhe nga kontributet e studentëve në formën e pagesave për rregjistrim. Kjo e fundit është mjaft e ulët në raport me vlerën e tregut të studimeve në arsimin e lartë. Arsimi i mesëm privat, si disa kolegje të licensuara nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë financohen nga burime private. Shpenzimet për arsim në Buxhetin e Kosovës përbëjnë rreth 15% të shpenzimeve totale buxhetore (11.8% për arsimin parashkollor, fillor dhe të mesëm, 0.18% për arsimin e personave me nevoja specifike/aftësi të kufizuara dhe 2.1% për arsimin e lartë). Në fondet për arsimin fillor dhe të mesëm shpenzimet për paga janë më të mëdha se shpenzimet për mallrave, shërbimeve dhe konsum kapital (81%-86.5% të shpenzimeve totale për arsim të mesëm dhe të lartë janë për paga). Paga mesatare mujore në institucionet e arsimit publik në 2003 ishte rreth 143 €. Sistemi i financimit të arsimit është

treguar jo efikas, e sidomos për arsimin e lartë. Në mesin e arsyeve për këtë joefikasitet konsiderohet të jetë niveli i lartë i centralizimit të vendim-marrjes dhe i mungesës së stimujve për punë më efikase. Në këto rrethana institucionet arsimore shpesh janë përballuar me mungesë fondesh edhe për nevojat e tyre elementare.

7. **Qeverisja dhe legjislacioni:** Ligji mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm parasheh të drejtë për arsimim dhe specifikon qëllimet e arsimit. Ai parasheh parimin e mosdiskriminimit dhe rregullon organizimin dhe shpërndarjen e arsimit dhe përgjegjësitë e MASHT, komunave dhe prindërve. Procesi i fundit i decentralizimit të arsimit elementar dhe të mesëm nuk ka përfunduar: Drejtorët e shkollave ende emërohen nga MASHT, megjithëse transferimi i kompetencave mbi punësimin e mësuesve tek komunat ka hyrë në fuqi që nga data 1 Janar 2003. Komuna është përgjegjëse për punësimin dhe dhënien e pagave për administratorët komunalë të arsimit, stafin mësimdhënës dhe jo mësimdhënës të institucioneve publike. Ligji mbi Arsimin e Lartë është aprovuar në Maj të 2003. Ky Ligj është hartur në pajtim me zhvillimet e fundit në sistemet europiane të arsimit të lartë. Ligji në mënyrë të veçantë thekson nevojën që sistemi i arsimit të lartë të Kosovës të reformohet drejt objektivave të parashtruara nga procesi Bolonjës. Dy urdhëresat administrative në lidhje me Agjencinë për Akreditim të Kosovës dhe liçencimin e ofruesve private të arsimit të lartë kanë vënë bazat elementare të një sistemi të garantimit të cilësisë në arsimin e lartë.

Comment [n1]: Solely?

8. **Arritjet në procesin e reformave:** Arsimi i detyrueshëm është shtrirë deri në Klasën e 9 që nga viti shkollor 2002/2003 dhe kjo klasë shërben si orientim për arsimim të mëtejshëm. Financimi i shkollave fillore dhe të mesme (77% e shpenzimeve publike në arsim) që nga viti 2002 është përgjegjësi komunave dhe ai bëhet sipas numrit të studentëve. Problemi i mungesës së vazhdueshme të mësuesve të trajnuar po zbutet nga Fakulteti i Edukimit në Universitetin e Prishtinës në bashkëpunim me donatorë të huaj. Është përgatitur gjithashtu një kurrikulum pilot për arsimin e mesëm profesional. Problemi i mungesës së testeve të jashtme të bazuara në kurrikulum po adresohet nga Agjencia për Standarde dhe Vlerësim. Për herë të parë më 2003 u zhvillua testimi në nivel nacional për klasën e 9-të. Megjithatë infrastruktura në arsim mbetet e varfër, kurse pagat e mësuesve janë të ulta. Mungesa e fondeve të mjaftueshme në arsim është e evidente. Progresi në reformimin e arsimit të lartë ka qenë i ngadalshëm, megjithëse Universiteti i Prishtinës është në proces të ristrukturimit të programeve të tij në pajtim me Deklaratën e Bolonjës. Ka filluar të zhvillohet sektor privat në arsimin e lartë, i cili po tregon shenja inkurajuese të një qasjeje të re të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Pavarësisht prej reformave, sistemi i arsimit ende nuk është i orientuar kah outputet/rezultatet. Ka një mungesë të përgjithshme të masave nxitëse (stimulative) përsa i përket financimit dhe procesit të vendosjes së pagave, të cilat do të nxisnin rezultate më të larta.

Çështje kyçe të politikave në arsim

9. **Qeverisja dhe legjislacioni:** Nevojitet një decentralizim më i madh (edhe brenda vetë institucioneve arsimore), më shumë transparencë, përgjegjësi të definuara më mirë dhe përmisim i qeverisjes në sistemin arsimor. Në shkollat e mesme bordet ekzistuese të shkollave duhet të mbikqyrin menaxhimin e shkollës në mënyrë më aktive. Përsa i përket arsimit të lartë ka disa çështje kyçe të cilave u duhet kushtuar kujdes dhe që kanë nevojë për zgjidhje: mardhëniet mes Ministrisë dhe Universitetit të Prishtinës dhe Fakulteteve brenda tij (pozita dhe roli i Senatit të Universitetit, përfaqësimi dhe roli i akterëve të jashtëm) dhe shkalla e autonomisë të Universitetit. Legjislacioni aktual megjithëse siguron liri akademike dhe autonomi për universitetin nuk ofron një mekanizëm të mjaftueshëm sipas të cilit Universiteti dhe Ministria mund të punojnë së bashku në mënyrë efektive për promovimin e zhvillimit të një universiteti modern dhe të përqendruar në outpute/rezulate.

10. **Matja e outputeve dhe menaxhimi i bazuar në performansa:** Anketat tona tregojnë që institucionet arsimore në Kosovë nuk kanë traditë në matjen sistematike të rezulateve të arsimit.

Sistemi i ri i Menaxhimit të Arsimit në MASHT deri tani është përqëndruar në zhvillimin e sistemeve për regjistrimin e numrit aktual të nxënësve dhe përcjelljen e pjesëmarrjes së tyre dhe të shkallës e ndjekjes së arsimit. Universiteti nuk ka ndonjë sistem për vlerësimin e gjasave për punësim të studentëve të tij apo masa të tjera me karakter më të gjerë për të vlerësuar efektivitetin e mësimdhënies dhe strategjitë e mësimin në nivel të moduleve, programeve dhe fakulteteit. Në përgjithësi, sistemi i arsimit në Kosovë është i orientuar kah inputet e jo nga outputet dhe nuk egziston një skemë motivuese për institucionet e arsimit për të rritur përpjekjet e tyre për të tërhequr më shumë nxënës dhe studentë me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes në arsim.

11. **Financimi:** Duket se ekziston një pajtueshmëri se prioritet i financimit duhet të jenë zgjerimi i pjesëmarrjes në arsimin parashkollor dhe arsimin pas atij të detyrueshëm (pas klasës së 9), zvogëlimi i shkallës së mosvijueshmërisë së rregull të mësimin, shpenzime më të mëdha kapitale për shkollat dhe arsimin e lartë, përmisimi i cilësisë dhe, si kusht për rritjen e efikasitetit, paga më të larta për mësimdhënës. Interesimi i madh për tu regjistruar në UP dhe zhvillimi i sektorit privat në fushën e arsimit të lartë është tregues se ka mundësi të rritet pjesëmarrja e financimit privat në arsimin e lartë. Ndryshe nga praktika në Evropë dhe në vendet e OECD-së, decentralizimi në Kosovë ka marrë formën e delegimit të autoritetit mbi buxhetin nga qeveria qendrore tek komunitatet e jo tek shkollat. Si rezultat i kësaj janë paraqitur probleme në lidhje me aplikimin e një formule të financimit dhe në mungesën e motivimit dhe nxitjes së komunave për të ndërmarrë hapa që mund të mos përkrahen nga komuniteti, siq është për shembull reduktimi i stafit të panevojshëm nëpër shkolla apo mbyllja e disa paraleleve të ndara ose bashkimi i shkollave. Monetalisht drejtorët e shkollave nuk kanë kompetenca në lidhje me shpenzimet. Ekziston një pakënaqësi e theksuar e fakulteteve lidhur me kompetencat e tyre për menaxhimin e buxheteve.
12. **Vlerësimi/testimi i jashtëm i bazuar në kurrikule dhe orientimi për karrierë:** Njësia për Standarde dhe Vlerësim në MASHT ka organizuar testin kombëtar në fund të klasës së 9, që është mbajtur për herë të parë në qershor të vitit 2003, por ende shkollat dhe as nxënësit nuk kanë informata për rezultatet e këtij testimit në mënyrë që të nxjerrim përcojat e duhura. Poashtu nuk është bërë vlerësimi i efektivitetit të instrumenteve të përdorura në këtë testim. Këto teste duhet të dizajnohen ashtu që të vlerësojnë se sa nxënësit i kanë kuptuar kurrikulet dhe gjithashtu të ofrojnë informata për shkollat, prindërit dhe nxënësit. Mosvënja e theksit në matjen e outputeve të sistemit të arsimit të Kosovës është e dukshme veçanarisht tek mungesa a sistemit të këshillimit për karrierë dhe dhe për profesion. Ka të ngjarë që roli i shkollave (në të gjithë arsimin e mesëm dhe të lartë) nuk kuptohet si përgatitje e personave për punë. Shkathtësitë e përgjithshme që janë të nevojshme në një ekonomi të bazuar në dije (të diskutuar në pjesën 2.2) nuk duket se janë mjaft presente në kurrikule të arsimit të mesëm dhe të atij të lartë.
13. **Reforma universitare:** Universiteti i Prishtinës është një nga pasuritë (asetet) kryesore të vendit dhe si i tillë është institucioni më i popullarizuar i arsimit. Programet dhe modulet në kuadër të këtij Universiteti janë në proces të reformimit konform me Deklaratën e Bolonjës. Me reformat strukturore që kanë ndodhur, është krijuar midis tjera edhe Fakulteti i Edukimit. Megjithatë, duket se ende mungon një projekt i përpunuar mirë dhe operativ për kompletimin e reformës në të gjitha aspektet. Pavarësisht prej kësaj, Universitetit i mungën një sistem për monitorimin e cilësisë së kurseve që ofrohen, ka pak traditë në hulumtime dhe ka një strukturë të centralizuar të menaxhimit financiar ku Fakultetet nuk kanë kompetenca fare. Financimi i universitetit është plotësisht i pavaruar me outputet e tij. Dekanët dhe personeli akademik në përgjithësi kanë motivim të ulët, që pjesërisht vie si rezultat i pagave të ulët duke rezultuar kështu në mosmbajtje me rregull/sipas plani të ligjëratave nga ana e mësimdhënësve dhe me mbajtje të disa vendeve të punës. Së fundi, Universiteti po ballafaqohet me konkurrencën në rritje nga sektori privat, megjithëse një konkurrencë e këtij niveli duket e pamjaftueshme për të motivuar ndryshimet e nevojshme në sjellje dhe ristrukturimin e Universitetit të Prishtinës.

REKOMANDIMET – POLITIKAT QË DUHET ZBATUAR

Rritja e investimeve në arsim është ndër sfidat më të rëndësishme që duhet të përballojë ekonomia dhe shoqëria kosovare. Kjo rritje e investimeve kërkon një kombinim të rritjes së shpenzimeve qeveritare, pjesëmarrje më të lartë të fondeve private të brendshme dhe rritje të financimit nga donatorët. Me anë të këtyre fondeve mund të vihen bazat e një sistemi modern të arsimit i aftë që të përballojë sfidat e ekonomisë së diturisë, globalizimit dhe zhvillimeve të hovshme teknologjike.

Në vendin tonë, lypset të merren masa përkatëse për rritjen e nivelit të përfshirjes së gjërneratave të reja në nivele të ndryshme të arsimit, veçmas në edukimin parashkollor, në përfshirjen më të madhe të vajzave në shkollimi e mesëm dhe të rinjve në arsimin e lartë.

- Pjesëmarrja e shpenzimeve për arsim duhet të rritet gradualisht nga niveli aktual prej 15% të shpenzimeve të përgjithshme qeveritare sa është në vitin 2004. Megjithatë, duke pasur fondet e kufizuara publike/qeveritare për arsim, **sistemi i arsimit duhet të caktojë prioritetet dhe të dizajnojë masat për tërheqjen e fondeve private dhe donacioneve ndërkombëtare.** Në praktik kjo nënkupton tërheqjen e fondeve private në arsimin e lartë si më poshtë:
 - Të hyrat nga participimi i studentëve në Universitetin e Prishtinës duhet të rriten.
 - Duhet të dizajnohet një skemë që do parashihte nivele të ndryshme të participimit të studentëve në financimin e arsimit të lartë e cila skemë do ishte e lidhur me provimin/testin në fund të klasës së 12 që do të mund të aplikohet në vitin 2006. Skema do parashihte që me rastin e regjistrimit në Universitet, x% të nxënësve që tregojnë rezultate më të mira në këtë provim nga secila shkollë e mesme do tu mundësohet të paguajnë participim të ulët siq është tani (normalisht duke pasur parasysh se ata plotësojnë kushtet e nevojshme për regjistrim në Universitet). Vendet e mbetura pas regjistrimit të këtyre x%, do tu ofrohen studentëve të kualifikuar por që duhet të paguajnë çmimin e tregut të studimeve. Të hyrat shtesë që sigurohen duhet të mbahen nga Universiteti për të financuar pagat më të larta për stafin akademik, për të përmirësuar sistemin informatik të menaxhmentit dhe zhvillimin e kurrikuleve të cilat do të ndikonin në rritjen e interesimit për të studiuar
 - Me qëllim të parandalimit të rritjes tepër të madhe të Universitetit të Prishtinës (UP) dhe me qëllim të krijimit të hapësirës për institucione private të arsimit të lartë, MASHT duhet të kontraktojë UP-në për ofrimin e vendeve fikse për studentë në studimet e rregullta.
 - Fondet që MASHT ofron për Universitetin duhet të bazohen në një formulë që garanton se të gjithë studentët që financiohen nga qeveria mbarojnë studimet për kohën më të shkurt të specifikuar. Studentët që përsërisin vitin akademik për shkak të rënjes nga provimet duhet të obligohen nga Universiteti që të paguajnë participim më të lartë që reflekton mungesën e subvencionimit nga MASHT.
 - Studimet me korespondencë duhet të futen në Universitet, me një participim i cili së paku mbulon shpenzimet dhe që është i barabartë ose më i lartë se participimi që paguhet nga studentët e rregullt. Në kuadër të këtyre studimeve me korespondencë duhet të përfshihen edhe kurset e shkurtëra profesionale që nuk janë të lidhura me fitimin e ndonjë titulli. MASHT mund të subvencionojë programet me korespondenë të zhvillimin profesional të mësimdhënësve në arsimin fillor dhe të mesëm si dhe të stafi mjekësor.
 - Participimi në kurset e studimeve pasdiplomike duhet që në shumicën e rasteve të mbulojnë së paku shpenzimet, megjithëse MASHT mund të subvencionojë studimet pasdiplomike në Fakultetin e Edukimit dhe në atë të Mjekësisë.

- Shkathtësitë për ndërmarrësi dhe për gjenerim të të ardhurave të stafit akademik duhet të drejtohen kah rritja e të ardhurave të jashtme të Universitetit (të të ardhurave jashtëbuxhetore). Kjo nënkupton paga më të larta për stafin akademik, por që këto paga të janë të lidhura me performancat e tyre në aktivitetin kërkimor, si dhe gatishmërinë e Universitetit për të nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me përfitim të dyanshëm me asociacione hulumtuese dhe me institute të ndryshme.
 - Ministria në bashkëpunim me Universitetin duhet të ndërtojë sistemin e punës kërkimore dhe shkencore në institucionet e arsimit të lartë nga fondet publike, fondet ndërkombëtare dhe fondet private (nga bizneset) duke krijuar kështu mundësi komplementare për rritjen e buxhetit.
 - Fondet shtesë të gjeneruara që u përshkruan më lartë duhet t'i mundësojnë Universitetit të përmirësojë Sistemin Informatik të Menaxhimit dhe zgjerimin e aktiviteteve ndërkombëtare, e posaqërisht me Universitetet ku mësimi mbahet në gjuhën shqipe. Universiteti duhet plotësisht të inkuadrohet për Hapësirën Evropiane të Hulumtimit dhe t'i implementojë reformat në përputhje me procesin e Bolonjës.
 - Në përgjithësi, institucionet e arsimit, e posaqërisht Universiteti i Prishtinës, duhet të privatizojnë shumicën e shërbimeve të tyre dhe të eliminojnë subvencionet për çështje që nuk janë të lidhura me studimet (si p.sh. konviketet, ushqimi në menza etj.). Kjo duhet të ndihmoi reduktimin e numrit të madh të stafit jo-akademik dhe të përmirësoi raportin e stafit jo-akademik ndaj atij akademik në gjithë sistemin e arsimit.
 - Në gjithë sistemin e arsimit duhet të inkurajohet ofrimi i kurseve të mbërmjes/vikendeve me pagesë për personat e rritur si formë e arsimit permanent (lifelong learning), që gjithashtu mund të jetë, që gjithashtumund të jetë arsimim plotësues i cili ndihmon në arritjen e rezultateve të dëshiruara.
- Për të kompletuar strukturat e nevojshme për një sistem modern të arsimit në Kosovë **duhet bërë ndryshime shtesë në strukturën qeverisëse dhe në kornizën legjislative** që ka të bëjë me arsimin:
 - Duhet të rritet roli dhe efektiviteti i punës së Bordeve të Shkollave të mesme në kuadër të një sistemi më të decentralizuar. Këto borde duhet të përgatisin dhe menaxhojnë planin vjetor të shkollës dhe gjithashtu të jenë përgjegjëse për përgaditjen e raportit vjetor i cili duhet tu shpërndahet prindërve dhe komunës.
 - Statuti i ri i Universitetit të Prishtinës duhet të jetë në pajtim me ligjet në fuqi dhe duhet të marrë parasysh rolin dhe autoritetin e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) në përcaktimin e politikave kombëtare dhe në vendosje e prioriteteve. Ky status duhet të jetë i orientuar më tepër kah studenti (dhe jo i orientuar kah akademikët).
 - MASHT duhet të ketë përfaqësuesit e saj në Senatin e Universitetit nëpërmes të cilëve mund të ndikojë në politikat që zbatohen në Universitet. Përfaqësuesit e Ministrisë në Senatin e Universitetit, gjithashtu, do të kontribuonin edhe në shkëmbimin e informatave në mes të MASHT-it dhe Universitetit.
 - Është me rëndësi të madhe që legjislacioni mbi arsimin e lartë të jetë i qartë. Procedurat për licencim, akreditim dhe riakreditim dhe operim të institucioneve të arsimit të lartë duhet të jenë transparente duke minimizuar çështjet që nuk përkufizohen në nivel qendror.
 - I gjithë sistemi i arsimit duhet të orientohet në rritjen e rezultateve të dëshiruara (outputit) dhe jo në inpute. Kjo kërkon që të zbatohet dhe **të forcohet roli i sistemit të menxhimit të performancave** nëpërmjet:

- Mbledhjes së të dhënave për outputet (suksesin/rezultatet) e sistemit të arsimit në të gjitha nivelet.
 - Vazhdimin me testim/provimin nacional në fund të klasës së 9 por të forcohen lidhjet e tij me kurrikulet që zbatohen.
 - Testimit/provimin të jashtëm i bazuar në kurrikule në fund të klasës së 12 duhet të mbikëqyret nga një agjencion i pavarur për standarde dhe vlerësim, dhe ky testim/provim duhet të zëvendësoj provimin pranues në Universitet. Suksesi i nxënësve në nivele dhe lëndë të caktuar duhet përdoren si kriter për regjistrim në arsimin e lartë. Në disa fakultete, (për shembull në atë të Edukimit dhe të Mjekësisë), në procesin e seleksionimit të studentëve për tu regjistruar mund të aplikohet edhe intervista.
 - Universiteti i Prishtinës duhet të ndërtojë bazën e të dhënave mbi studentët për të bërë të mundur monitorimin e suksesit si dhe normën e diplomimit të tyre në module dhe programe të ndryshme. Suksesi dhe performancat e çdo mësimit duhet të maten çdo semestër.
 - Në nivel të Fakulteteve dhe të programeve duhet të zhvillohen indikatorët e matjes së performancave, ku përfshihen: norma e diplomimit, gjatësia mesatare e studimeve, pjesëmarrja në programe të caktuara e minoriteteve dhe grupeve të marginalizuara dhe eventualisht norma e punësimit të studentëve të diplomuar.
 - Duhet të aploket një lloj inspektimi (kontrolli) i rregullt i cilësisë së punës në secilin fakultet nga persona të jashtëm, ku vlerësimet dhe opinionet e studentëve paraqesin element kyç. Në këtë proces duhet të inkuadrohen specialist të lëmive të caktuar nga jashtë dhe, në një afat më të gjatë, mund të mendohet për themelimin e një agjencioni për kontroll të cilësisë në nivel të Universiteteve në gjuhën shqipe.
 - Rritja e pagave të mësimit duhet të jetë e lidhur me performancat e tyre e posaqërisht me zhvillimin profesional të tyre. Në kuadër të Universitetit, promovimi i mësimit duhet të bëhet në bazë të efikasitetit të punës së tyre si mësimit (i cili efikasitet duhet të jetë i matshëm), si hulumtues (në bazë të numrit publikimeve në revista shkencore) dhe evidencës tjetër të zhvillimit profesional siq është numri i teksteve të përgatitura në gjuhën shqipe.
- Për të rritur efikasitetin e sistemit të arsimit dhe nivelin të përgjithshëm të përfshirjes në arsim në të gjitha nivelet **duhet të rritet konkurrenca në mes të institucioneve dhe të bëhet decentralizimi i vendim-marrjes:**
 - Për të rritur nivelin e efikasitetit të punës në shkolla, rezultatet e testit kombëtar në klasën e 9 dhe 12 duhet të publikohen. Kjo do të inkurajojë prindërit për të kërkuar më shumë llogari nga shkollat dhe për të bërë presion mbi drejtorët e shkollave dhe mësimit që të orientohen më shumë kah outputet.
 - Sikurse në shkolla të mesme, edhe në Universitet duhet të publikohen rezultatet mbi numrin e të diplomuarve dhe gjatësinë mesatare të studimeve në nivel të fakulteteve dhe programeve duke u orientuar kështu kah outputet,
 - Aplikimi i sistemit të participimit dy-nivelësh nga studentët do iu mundësoi institucioneve private të konkurojnë më drejtëpërdrejtë me UP-në, megjithëse ka nevojë edhe për mekanizma të tjerë për të promovuar këtë konkurrencë. Një mundësi për të rritur konkurrencën brenda Universitetit është ristrukturimi i Universitetit të Prishtinës dhe ndarja e tij në 3-4 institucione të pavarura.
 - Rekomandohet që të analizohet më tutje mënyra e organizimit optimal të arsimit të lartë në Kosovë, e veçanërisht të analizohen përparësitë dhe të metat e riorganizimit të Universitetit në 3-4 institucione apo alternativa e një dispersioni rajonal.
 - Drejtorëve të shkollave dhe fakulteteve duhet tu jepet më shumë përgjegjësi dhe autoritet për të menaxhuar me buxhetin e tyre. Delegimi i autoritetit dhe

- përgjegjësisë mbi buxhetin tek fakultetet shihet si një alternativë për të stimuluar për përmirësuar efikasitetin e tyre.
- Fondet duhet të alokohen në bazë të numrit të studentëve/nxënësve. Në Universitet me rastin e alokimit të fondeve nëpër fakultete duhet të përdoren peshat specifike të kostove të studimit për një studentë në programe të ndryshme që përdoren ndërkombëtarisht.
- Të gjitha nivelet e sistemit të arsimit **duhet të forcojnë lidhjet me tregun e punës** dhe të inkurajojnë rritjen e vetë-punësimin:
 - Duhet të bëhen një vlerësim i rregull sesa u mësohen nxënësve dhe studentëve shkathhtësitë e përgjithshme që janë kyçe dhe që kërkohen në tregun e punës.
 - Duhet të zhvillohet një sistem i këshillimit për karrierë në kuadër të shkollave dhe të institucioneve të arsimit të lartë.
 - Shkollat dhe Universiteti duhet të vëjnë kontakte të rregullat me punëdhënës si dhe të kujdesen për mundësitë për punësim të atyre që mbarojnë arsimin.
 - Trajnimi fillestar për mësimdhënës dhe “trajnimi gjatë punës” duhet të përfshijë edhe trajnimin e mësimdhënësve për këshillim për karrierë,
 - Universiteti i Prishtinës duhet të zhvillojë module ku do mësohej planifikimi i karrierës dhe zhvillimi profesional, të cilat module do u ofroheshin të gjithë studentëve.

1. HYRJE

Rëndësia e kapitalit njerëzor për rritjen ekonomike është tanimë e njohur. Kapitali njerëzor është një element bazë për rritjen ekonomike të qendrueshme dhe të shpejtë. Posaqërisht kapitali njerëzor është i rëndësishëm për vendet në tranzicion pasi këto vende janë duke reformuar ekonomitë e tyre drejt ekonomive të tregut. Ndërsa progresi drejt ekonomisë së tregut në fazat e para të tranzicionit varet nga vullneti dhe vendosmëria e qeverisë për zbatimin e reformave, zhvillimet në fazat e mëvonshme të këtyre ekonomive varen kryesisht nga aftësia e kapitalit njerëzor për të përfituar dhe përdorur njohuritë e nevojshme për ndrëtimin e aftësisë konkurruese të ekonomisë.

Kjo e ka nxitur edhe Institutin Riinvest që në kuadër të projektit “*Promovimi i Zhvillimit Ekonomik nëpërmjet Shoqërisë Civile*”, të adresoi këtë qështje me një modul të pavarur: “*Sistemi i arsimit dhe zhvillimi ekonomik i Kosovës*”. Ky projekt realizohet me mbështetjen e USAID-ti, zyra në Prishtinë. Raporti hulumtues i në kuadër të këtij moduli ka qenë i fokusuar në arsimin e mesëm dhe të lartë. Objektivat e këtij raporti janë:

- Të nxisë një debat të hapur dhe itenziv në mes të vendim-marrësve, shoqërisë civile dhe institucioneve të edukimit mbi sistemin edukimit në Kosovë, reformat aktuale dhe rëndësinë e edukimit për zhvillimin ekonomik,
- Të ngrit vetëdijen e vendim-marrësve dhe akterëve tjerë kyç mbi rolin e një sistemi modern të edukimit për t’i rritur mundësitë e gjeneratave të reja të Kosovës që plotësisht të jenë të angazhuara dhe të kontribuojnë në progresin ekonomik,
- Duke u bazuar në hulumtimet mbi gjendjen aktuale të sistemin e edukimit, përvojat relevante nga vendet tjera dhe sfidat e të ardhmes të rekomandoj politikat e nevojshme për të vënë bazat e një sistemi efikas të edukimit që do të mundësoi zhvillim më të shpejtë ekonomik.

Për hartimin e këtij raporti hulumtues janë zhvilluar këto aktivitete:

- (i) Takime me aktorët kyç të sistemit arsimor në Kosovë (*Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Qendra për Arsim e Kosovës, Zyra e Bankës Botërore në Prishtinë, Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, Universiteti i Prishtinës dhe disa nga Fakultetet e tij, Shkollat e mesme, organet komunale të arsimit, Kolegji Privat i Arteve dhe Shkencave Sociale, Universiteti Amerikan i Kosovës, Drejtori i Departamentit për Arsim në Komunën e Prishtinës, etj*),
- (ii) Analizimi i studimeve në dispozicion dhe publikimeve për sistemin arsimor në Kosovë,
- (iii) Vështrim mbi studimet (raportet hulumtuese) e Riinvestit,
- (iv) Anketa me 100 mësimdhënës të shkollave të mesme dhe 92 mësimdhënës universitetit dhe anketa me 375 studentë të Universitetit,
- (v) Intervista të hollësishme me 19 drejtorë të shkollave të mesme në të gjithë Kosovën dhe 8 dekanë të Universitetit të Prishtinës (UP),
- (vi) Analiza e ligjeve dhe rregulloreve mbi sistemin arsimor,
- (vii) Analiza e eksperiencave nga vendet në tranzicion dhe vendet me ekonomi të zhvilluar në lidhje me reformën e sistemit arsimor dhe arritjet e tyre me interes për Kosovën,
- (viii) Dy seminare të mbajtur nga dy konsulentët e huaj:
 - “*Arsimimi dhe performancat ekonomike*” nga Profesor Nick Adnett;
 - “*Reformimi i Arsimit të Lartë: Mësime të nxjerra nga vendet në tranzicion*” nga Profesor Marek Kwiek.

Si pjesë e asistencës teknike për këtë modul, Riinvesti ka kontraktuar dy ekspertë të jashtëm: Profesor Nick Adnett nga Instituti për Hulumtime dhe Politika në Arsim, Universiteti i

Staffordshirit (Mbretëria e Bashkuar) dhe Profesor Marek Kwiek nga Qendra për Politika Publike në Universitetin e Poznanit (Poloni).

Raporti, përveq përmbledhjes ekzekutive dhe rekomandimeve që janë dhënë në fillim, përbëhet nga katër kapituj, ku hyrja është kapitulli i parë.

Në kapitullin 2 fillimisht jepen fakte mbi rolin e arsimit në zhvillimin ekonomik. Pasatj diskutohen politikat aktuale në vendet e BE-së dhe OECD-së. Më pas diskutohet rëndësia e arsimit për zhvillimin ekonomik në Kosovë së bashku me një analizë të shpenzimeve qeveritare në arsim dhe çështjet e lidhura me qeverisjen edhe legjislacionin.

Në kapitullin 3 përshkruhet gjendja aktuale në arsimin e mesëm dhe të lartë. Pasatj jepet një vlerësimi i përgjithshëm i sistemit shkollor duke shfrytëzuar të dhënat nga anketa me mësimdhënës të shkollave të mesme dhe mësimdhënës universitar (*shih në listën e aktiviteteve mësipër pikën iv*), anketa me studentët e Universitetit (*shih më sipër pikën v*), intervistat e hollësishme me drejtorët e shkollave të mesme dhe dekanët e disa fakulteteve në kuadër të UP-së (*shih më sipër pikën vi*).

Në kapitullin 4 diskutohen disa çështje kyçe të politikave për fuqizimin e kontributit të sistemit arsimor në zhvillimin ekonomik. Këtu trajtohen çështje të lidhura me qeverisjen dhe çështjet ligjore, matja e rezultateve dhe shtrirja/zbatimi i sistemit të menaxhimit në bazë të performansave, çështjet e financimit, vlerësimi i jashtëm, orientimi apo këshillimi për karrierë dhe reforma e Universitetit.

Instituti Riinvest dëshiron të falënderojë për kontribut në përgatitjen e këtij raporti hulumtues këta personat dhe institucione:

- (i) Zyra e USAID-it në Kosovë për mbështetjen e këtij projekti dhe për diskutimet përmbajtësore/konstruktive,
- (ii) Dy konsulantët: Profesor Nick Adnett dhe Marek Kwiek për kontributin e shkëlqyer gjatë vizitës së tyre në Riinvest,
- (iii) Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për gadishmërinë e treguar për t' u takuar me ne disa herë dhe për të ndarë informacione me ne,
- (iv) Drejtorët e shkollave të mesme dhe dekanët e disa fakulteteve për gadishmërinë e treguar për t' u takuar dhe për të na ofruar informatat e kërkuara nga ne,
- (v) Studentët të angazhuar në mbledhjen e të dhënave,
- (vi) Qendrën për Arsim të Kosovës për pjesëmarrje në takimet gjatë fazes përgaditore të këtij projekti si dhe në takimet e mëvonshme për të diskutuar ide të ndryshme.

2. ARSIMI DHE ZHVILLIMI EKONOMIK I KOSOVËS

2.1 Arsimit dhe Performansat Ekonomike

Vite të fundit shumë qeveri janë duke e trajtuar arsimin, dhe veçanërisht arsimin e lartë, si një përcaktues shumë të rëndësishëm të performansave ekonomike të vendeve të tyre (shih boks 1). Ndër arsytet për këtë vëmendje të shtuar kah arsimi janë të shumta. **Së pari**, për ekonomitë e zhvilluara duket se ekziston një ndërlidhshmëri e qëndrueshme mes arritjeve në arsim dhe performansave ekonomike. *OECD*-ja (2003b) vlerëson se një vit shkolle shtesë rrit outputin afatgjatë me 6%.¹ Kurse *De la Fuente dhe Ciccone* (2002) kanë konkluduar se një vit shkolle shtesë në popullatën në tërësi e nxit rritjen në planin afatshkurtër me 5 % dhe një rritje tjetër shtesë prej 2.5% në afat të gjatë. Kjo arrihet pasi niveli më i lartë i arsimimit ndikon në produktivitetin shumë më të lartë në punë, inovacione dhe shfrytëzim më të shpejtë të teknologjive të reja. E para reflekton faktin që investimet reflektohen tek individët në formë të përfitimëve/të ardhurave më të larta dhe periudhë më e shkurtër e papunësisë dhe mospjesëmarrjes në tregun e punës.

Megjithatë, kjo ndërlidhshmëri mes arsimit dhe rritjes ekonomike është më komplekse. Qytetarët në vendlindje e pasura kërkojnë më shumë arsimim edhe për arsye jo ekonomike, ndërsa për vendet në zhvillim studiet e ndryshëm me ante të metodave ekonometrike kanë gjetur se ekziston një lidhje e vogël apo munges e lidhjes mes rezultateve të arsimit dhe rritjes ekonomike. Kjo është pasojë e “shpërnguljes së trurit”, korrupsionit dhe infrastrukturës së varfër ligjore që e bën të vështirë shndërrimin e produktivitetit të shumicës së njerëzve të arsimuar në të mira për shoqërinë si tërësi. *Rogers* (2003) nxjerr si përfundim që rezultatet e arsimit të lartë gjenerojnë rritje më të shpejtë ekonomike vetëm në vendet me shkallë të ulët të korrupsionit, ekonomi të vogël informale dhe nivel të ulët të emigracionit mes shtresave më të arsimuara. Këto rezultate janë veçanërisht të rëndësishme për Kosovën dhe sugjerojnë nevojën për reforma në fusha të tjera krahas atyre në arsim.

Faktori i dytë që ka përforcuar rëndësinë e politikave në arsim ka qënë rezultatet e nxjerra nga disa studime prestigjioze (*TIMSS* dhe *PISA*) ku janë krahasuar nivelet e arritjeve arsimore në mes të vendeve. Në bazë të këtyre rezultateve, sidomos për nxënësitë me aftësi mesatare ose nënmesatare, *SHBA* dhe shumë vende të Evropës Perëndimore tregojnë rezultate të dobta krahasuar me Azinë Juglindore dhe vendet skandinave. Tek vendet e para, kjo ka çuar drejt zhvendosjes së fokusit nga inputet tek matja dhe rritja e rezultateve të arsimit.

Boksi 1: Benefitet ekonomike dhe shoqërore për individët dhe shoqërinë nga arsimimi i lartë

Benefitet	Private	Publike
Ekonomike	Paga më të larta Punësim më i rregulltë Pjesëmarrje më e lartë	Produktivitet më i lartë Zhvillim kombëtar dhe rajonal Të ardhura tatimore më të larta dhe zvogëlimi i mbështetjes tek financat qeveritare.
	Kushte pune të përmisuara Rritje e mobilitetit personal dhe profesional	Konsum i rritur Potencial më i lartë për transformime nga ekonomia e bazuar në sektore ku kerkohen aftësi të vogla në ekonomi të bazuar në dije
Sociale	Cilësi e jetës e përmirësuar për veten dhe fëmijët Vendimmarrje më e mire	Ndërtimi i vendit dhe zhvillimi i lidershitit Pjesëmarrje demokratike; percepton më i lartë që shoqëria bazohet në drejtësi dhe mundësi për të gjithë qytetarët
	Status personal i përmisuara Mundësi arsimimi të rritura Stil jete më i shëndetshëm dhe jetëgjatësia e pritur më e madhe.	Mobilitet social Koherencë sociale më e madhe dhe nivele të zvogëluara të krimit Shëndet i përmirësuar Aspirata arsimore dhe ekonomike më të larta për fëmijët e tyre

(burimi: Banka Botërore 2002b: 81)

¹ P.sh. nëse vitet mesatare të arsimimit për popullatën 25-64 vjeç rriten nga 17 në 18, atëherë outputi (BPV) në periudhë afatgjatë rritet me 6%.

Tendenca për rritjen e kuotës së shpenzimeve për arsim nga mesatarja aktuale prej 6% e GDP-së në vendet e OECD-së është **faktori i tretë**, i cili shoqëron shqetësimin në rritje për politikën arsimore. Pjesërisht kjo rritje reflekton tendencën për rënien e numrit e nxënësve për klasë, por gjithashtu rezulton edhe nga tendenca për rritjen relative të çmimit të arsimit. Kjo nga ana tjetër reflekton efektet e teknologjisë, e cila rrit pagat e mësuesve, por deri më tani jo edhe produktivitetin e tyre. Pra në kushtet e presionit buxhetor, qeveritë po shqetësohen gjithnjë e më shumë për efektivitetin e sistemeve të tyre arsimore, si dhe për zvogëlimin e pjesëmarrjes së shpenzimeve qeveritare në shpenzimet për arsim (mesatarja e aktuale e OECD-së është 88%).

Së fundi, globalizimi, ekonomia e re dhe rritja e mobilitetit gjeografik të punëtorëve me produktivitet të lartë të punës kanë bërë që vemendja e qeverisë të drejtohet në rritjen e konkurrencës në nivel global dhe të bazuar në dije. Cilësia e shkathtësive të fuqisë punëtore të një vendi shihet si një përcaktues vendimtar i aftësisë së tij konkurruese globale. Në BE ky shqetësim nxorri në dritë Strategjinë e Lisbonës, e cila tenton ta bëjë Evropën një ekonominë të bazuar në dije deri në vitin 2010. Në këtë Strategji, arsimit dhe politikën trajnuese kanë një rol kyç, megjithëse për momentin BE-ja rrezikon që të mos arrijë pesë standardet e përcaktuara nga Këshilli i Evropës në Maj 2003 (Komisioni Evropian, 2003a). Në veçanti, nxitja e arsimit gjatë gjithë jetës është në nivel të ulët, kurse nivelet e ndërprerjes së arsimit nga nxënësit dhe studentët si dhe lënja anash e grupeve të caktuara sociale janë tepër të larta. Për më tepër, nuk ka ndonjë shenjë për rritje substanciale të investimeve të përgjithshme qoftë publike apo private në kapitalin njerëzor.

2.2 Prioritetet aktuale të politikave në BE dhe OECD

Në këtë pjesë do të përqendrohemi tek gjashtë çështjet prioritare të paraqitura në shumicën e debateve për politikën në arsim në vendet antëtarë në BE dhe OECD e që janë me interes për Kosovën. Së pari këto reforma synojnë të krijojnë masa inkurajuese më të mëdha për shkollat, universitetet dhe mësuesit për të rritur rezultatet mësimore të studentëve të tyre. Në kuadër të këtyre politikave përfshihen regjistrimi i hapur në shkollat që krijojnë më shumë zgjedhje për prindërit dhe studentët dhe i bën kështu institucionet arsimore më të ndjeshme ndaj nevojave dhe preferencave të klientëve të tyre. Për më tepër, synohet të krijohen dhe të publikohen treguesit e performancave që mundësojnë krahasimet mes institucioneve, me qëllim të përmisimit të informacionit në dispozicion të prindërve dhe studentëve të nevojshëm për të bërë zgjedhjen e tyre. Me qëllim që të lejohen shkollat, kolegjet dhe universitetet t'u përgjigjen këtyre forcave të reja, qeveritë kanë decentralizuar në mënyrë të dukshme vendimmarrjen dhe përgjegjësitë buxhetore tek institucionet arsimore individuale. Duket se vetëm nëse institucionet arsimore kanë kontrollin e burimeve financiare të tyre, mund të pritët që ato tu përgjigjen plotësisht këtyre presioneve të reja dhe të mund të fokusohen në rritjen e rezultateve të arsimit (Adnett and Davies, 2002).

Së dyti, siç u tregua edhe më lart, një rol kyç i reformave të tregut ka qënë prezantimi ose zgjerimi i menaxhimit nëpërmjet performancave në institucionet shtetërore të arsimit. Theksi tani është zhvendosur nga inputet tek rezultatet e arsimit (outputet). Publikimi i treguesve mbi performancat inkurajon konkurrencën ku institucionet krahasojnë performancat e tyre me ato të shkollave apo universiteteve të ngjashme. Për më tepër, qeveritë gjithnjë e më shumë po caktojnë objektiva të tipit SMART për këto institucione. SMART nënkupton që objektivat janë: Specifike, të Matshme, të Arritshme, Relevante dhe të Afatizuara. Praktika në arsim dhe kudo në sektorin publik sugjeron që objektivat për përmisimin e performancave funksionojnë më mirë nëse për to kanë rënë dakort të gjithë akterët relevant sesa kur ato imponohen në mënyrë të njëanshme. Rezultatet janë më të mira edhe kur janë siguruar masa inkurajuese për të shpërblyer performancat e përmirësuar.

Së treti, ekonomia e bazuar në dije dhe zhvillimet teknologjike kanë ndikuar në rritjen e përfitimeve private nga arsimit dhe rritjen e rëndësisë të shkathtësive bazë të forcës punëtore. Për të qenë konkurrues forca punëtore e një vendi duhet të posedojë jo vetëm kompetencat kyçe tradicionale (leximin, shkrimin dhe llogaritjen bazike), por edhe shkathtësi teknike të transferueshme si zgjidhja e problemeve, komunikimi dhe aftësitë kompjuterike (IT). Në të njëjtën kohë rritja e vazhdueshme relative e sektorit të shërbimeve dhe të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme rrit kërkesën për aftësitë ndërmarrëse, për iniciativë dhe pranim të riskut. Për më tepër, rritjet në mobilitetin e punëtorëve dhe punëve kanë nxitur shqetësimin për zhvillimin e aftësive punëkërkuese të studentëve dhe përmisimin e ofrimit të orientimit profesional (OECD, 2003c). Këto zhvillime kanë inkurajuar qeveritë të hartojnë kurrikulume që zhvillojnë aftësitë e përgjithshme të transferueshme në të gjitha institucionet e arsimit të mesëm dhe të lartë. P.sh. si pjesë e Strategjisë së Lisbonës, BE-ja po zhvillon Kornizën Evropian të Shkathtësive Kyçe. Tetë fushat e këtyre shkathtësive janë: komunikimi në gjuhën amëtare, komunikimi në një gjuhë të huaj, njohuri në matematikë dhe aftësitë bazë në shkencë dhe teknologji, aftësitë në teknologji informative (ICT), të dish të mësosh, aftësitë ndërpersonale dhe civile, ndërmarrësia dhe vetëdijësimi kulturor (Komisioni Evropian, 2003b). Këto shkathtësi kyçe duhet të mësohen nga fundi i arsimit të detyrueshëm dhe të zhvillohen gjatë arsimit të mëtejshëm. Aftësimi (arsimimi) për të mësuar është thelbësor në garantimin e qasjes në mundësitë e mësimin të vazhdueshëm si dhe përshtatja me nevojat e ndryshueshme të punësimit dhe shoqërisë. Në këtë ambient shkollimi dhe orientimi për karrierë në veçanti duhet të ndihmojnë në zhvillimin e aftësisë për ta marrë vendime.

Së katërti, skemat që cilat synojnë mësimin bazë dhe për ndërtimin e aftësive shoqëruese të grupeve me rrezikshmëri të lartë përsa i përket lënies së shkollës në moshat e reja sjellin benefite më të larta se të gjitha politikat e tjera të shkollimit. Kjo reflekton efektivitetin e tyre në luftimin e përjashtimit shoqëror dhe eviton nivelet e larta të kriminalitetit dhe papunësisë. Në BE p.sh. aktualisht një në pesë veta e lë shkollën në moshë të re duke mbetur kështu pa kualifikim, kurse komponenti i trajnimeve sipas Strategjisë së Lisbonës kërkon që ky raport të përgjysmohet deri më 2010.

Fusha e pestë e politikave në arsim ka të bëjë me rritjen e vazhdueshme të pjesëmarrjes në arsimin e lartë në shumicën e vendeve të OECD-së. BE-ja vlerëson që rreth 80% e vendeve të reja të punës që do krijohen deri në 2010 do të kërkojnë arsimim të lartë (Komisioni Evropian, 2003a). Aktualisht 23% e meshkujve dhe 20% e femrave të grupmoshës 25-64 kanë arsim të lartë në BE krahasuar 36% të meshkujve dhe 32% të femrave në Japoni dhe 37% e të gjithë popullatës në SHBA. Përfitimet e larta tek individët si rrjedhojë e studimeve universitare kanë nxitur rritjen e kërkesave për regjitrin në univeristete në vendet e OECD-së. Megjithatë në vendet e OECD-së kosto e arsmimit të lartë për kokë është sa dyfishi i arsimit të mesëm dhe rritja e pjesëmarrjes shtuar presionin mbi buxhetet qeveritare. Si rezultat i këtij presioni janë bërë përpjekeje për t'i zhvendosur kostot e financimit tek prindërit dhe fëmijët me anë të tarifave më të larta për regjistrim, pra duke rritur pjesën e fondeve që vinë nga burimet private. Në disa vende rritja e kërkesës ka stimuluar edhe rritjen e institucioneve private të arsimit me pagesë.

Së fundi, për shkak të rritjes së kërkesës për të arsim të lartë si dhe perceptimi i rëndësisë ekonomike të tij ka ardhur deri te reformimi apo strukturimi i tij. Këto ndryshime shpesh kanë kombinuar autoritetin e shtetit dhe fuqinë e tregjeve në për të stimuluar përmisimin e efikasitetit dhe krijmtarisë (OECD, 2003c). Me këto ndryshime lidhen edhe aplikimi i menaxhimit sipas performasave në universite me synim drejt zgjërimit të pjesëmarrjes në arsim, pastaj zvogëlimin e numrit të atyre që braktisin shkollën si dhe për shkrutimin e gjatësisë mesatare të studimeve si dhe rritjen e shanseve për punësimin të të diplomuarve. Mekanizmat për ndarje të fondeve pjesërisht janë bazuar në performansat e universitetit sipas disa indikatorëve të paracaktuar, ndërsa dhënia e

autonomisë më të madhe verpruese ka qenë e lidhur ngushtë me vlerësimin e jashtëm të performancave të universiteteve. Në shumicën e vendeve të OECD-së tashmë ekziston një barazpeshë midis të kompetencave të qeverisë dhe pavarësisë institucionale ku qeveritë fokusohen në një numër të kufizuar qëllimesh të politikave, në të cilat mendohet se interesat publike janë më se të qarta (OECD, 2003c). Roli i qeverisë në përgjithësi është i koncentruar në përcaktimin e formulës së fondeve dhe burimeve të financimit, sigurimin e përgjeshmërisë financiare, ngritjen e agjencive të jashtme për të siguruar cilësinë e mësimdhënies, caktimin e përgjegjësive institucionale si dhe mbrojtjen e interesave të grupeve më të dobta.

2.3 Arsimi dhe Zhvillimi Ekonomik në Kosovë

2.3.1 Rëndësia e Arsimit për Kosovën

Në kushtet e ekonomisë së re, ekonomisë së bazuar në dituri, kapitali njerëzor i mishëruar në popullsinë e Kosovës është aseti ekonomik më i rëndësishëm i vendit. Ashtu si edhe në vendet e tjera, suksesi i sistemit arsimor Kosovës në ofrimin e shkathtësive kyçe që kërkohen në tregun e punës do të jetë i një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm ekonomik. Qasje e barabartë në një sistem arsimor modern është gjithashtu një faktor po aq i rëndësishëm për promovimin e barazisë dhe mirëqenies sociale si dhe për rritjen e mirëqenies së minoriteteve dhe grupeve të disfavorizuara (të marginalizuara).

Përmirësimi i standardeve të arsimit stimulon zhvillimin ekonomik në mënyrë direkte nëpërmjet efektit të tij në produktivitetin e punëtorëve. Për më tepër forca punëtore e arsimuar është më fleksibile dhe e adaptueshme dhe si rrejdhim i përgjigjet më mirë nevojave në ndryshim e sipër të ekonomisë Kosovare dhe Evropiane. Edhe hulumtimet në lidhje me tregun e punës, sistemin e arsimit dhe kapitalin njerëzor në Kosovës² tregojnë se në aspektin individual, niveli i shkollimit është një përcaktues kryesor si i probabilitetit për të siguruar dhe mbajtur vendin e punës, ashtu edhe për nivelin e të ardhurave në Kosovë – ata që janë më të arsimuar kanë më shumë mundësi për të qenë të punësuar dhe për të ardhura më të larta.³ Mbi të gjitha, nivelet e larta të arsimit të popullsisë në përgjithësi nxisin ndërmarrësinë si faktor i rëndësishëm i gjallërimit ekonomik.

Një faktor tjetër veçanërisht i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës është arsimimi modern që promovim shkathtësive kyçe të cilat nxisin vetëpunësimin. Së fundi, nivelet më të larta të rezultateve në arsim rrisin shanset e Kosovarëve për të konkurruar me sukses në tregjet e huaja të punës, krahas tregut të brendshëm. Hulumtimet⁴ tregojnë se niveli më i lartë i arsimit i personaev në forcën e punës rritet probabilitetit për të punuar jashtë. Pra me nivele më të larta të arsimit, remitancat për kokë nga Kosovarët që punojnë jashtë do të rriten dhe nëse edhe gjasat për punë jashtë rriten, këto remitanca do të rriten edhe më shumë. Për këto arsye shpenzimet në arsim duhe të shihn si investime, kthimet nga të cilat do të përshpëtojnë rritjen ekonomike. Është kjo karakteristikë që nxjerr në pah nevojës që Qeveria e Kosovës të caktojë si prioritet ndërtimin e mëtejme të një sistemi modern të arsimit dhe, sipas nevojë, rritjen e shpenzimeve të përgjithshme publike dhe private për arsimin.

Duke parë rëndësinë gjithmonë e më të madhe të arsimit të lartë në zhvillimin ekonomik, urgjentisht nevojiten të ndërtohen dhe të zbatohen politikat që synojnë rritjen e pjesëmarrjes në


² Hoti, A. dhe Adnett, N. (2004) Schooling in a High Unemployment Economy: The case of Kosova; *Staffordshire University Business School, Economics Division*, Working Paper Nr. 2004.01.

³ Po aty

⁴ Po aty

arsim në përgjithësi dhe në arsimin e mesëm dhe të lartë në veçanti.⁵ Sa për krahasim, regjistrimi në institucionet e arsimit të lartë në Kosovë më 2003 ishte rreth 10-12%, ndërsa në vendet post-komuniste si në Poloni ishte 30% (në SHBA 80% dhe në vendet e OECD 54%, shih pjesën a të figurës më poshtë). Mesatarisht në Kkosovë ka rreth 1000 studentë të përfshirë në arsimin e lartë Kosovë për 100,00 banorë, krahasuar me 1350 në Maqedoni dhe 4243 në Slloveni (shih pjesën b të figurës më poshtë). Të dy këto vende kanë popullsi të ngjashme me Kosovën. Rritja e numrit të studentëve është edhe më e rëndësishme duke patur parasysh faktin që shumica e vendeve të reja të punës kërkojnë arsimim të lartë. Duke pasur parasysh ndikimin në rritjen e aftësisë konkurruese, rritjes së përfshirjes në arsimin e lartë duhet t'i jepet prioritet me qëllim të rritjes së aftësinë konkurruese të ekonomisë Kosovare.

Figura 1: A) Pjesëmarrja në arsimin e lartë (krahasime në nivel ndërkombëtar); dhe B) Numri i studentëve për 100,000 banorë në E.JL (2000)



Burimi: CEPES/UNESCO, Bukuresht, Rumani, 2002 (mimeo)

Shumica e vendeve të reja të punës të krijuara në Kosovë gjatë katër viteve të fundit janë krijuar në sektorin e Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (NVM-të), ku aftësitë ndërmarrëse janë shumë të rëndësishme. Për rrjedhojë një sistem arsimor që i pajisë të diplomuarit me këto aftësi siguron punësim më të shpejtë si dhe rritje ekonomike e veçmas vetëpunësim. Megjithatë është e vështirë të vlerësohet se deri në ç' masë këto aftësi u ofrohen studentëve, ekziston përshtypja se arsimi i lartë në Kosovë duhet t'i zhvilloj më shumë programet që ofrojnë këto aftësi. Një anketë që e Institutit Riinvest ka përfunduar me NVM-të në Kosovë (Dhjetor 2003) tregon se 2/3 e menaxherëve janë pjesërisht ose nuk janë të kënaqur me aftësitë e të sapo diplomuarve që ata punësojnë. Ata konsiderojnë (rreth 71% e tyre) se problemet janë veçanarisht në mungesën e njohurive praktike.

Bazuar në të dhënat e anketës e Familjeve dhe Tregut të Punës e Riinvestit (Dhjetor 2002), vetëm 13% e popullsisë Kosovare të grupmoshës 25-64 kanë kualifikim arsimor të lartë (18% e meshkujve dhe 8% e femrave), krahasuar me 23% të meshkujve dhe 20% të femrave në BE, 36% të meshkujve dhe 32% të femrave në Japoni dhe 37% e të gjithë popullsisë së SHBA. Kjo përqindje e ulët e njërëzve me arsim të lartë dhe kërkesat në rritje të tregut të punës për këtë lloj kualifikimi do të ushtrojnë presion mbi sistemin arsimor në Kosovë për rritjen e kapaciteve të tij.

Tabela 1: Niveli i arsimit të popullsisë në Kosovë (grupmosha 25-64)

Niveli i arsimit	Meshkuj	Femra	Total
Më pak se fillor	0.02	0.10	0.06
Fillor	0.24	0.49	0.36
I mesëm	0.55	0.33	0.44
I lartë	0.18	0.08	0.13
Pa përgjigje	0.01	0.01	0.01
Total	1.00	1.00	1.00

Burimi: Anketa e Familjeve dhe Tregut të Punës e Riinvestit (Dhjetor 2002)

⁵ Niveli i analfabetizmit në Kosovë mendohet të jetë rreth 5.3% dhe është më i lartë tek femrat dhe tek ata që jetojnë në zonat rurale (Anketa e Familjeve dhe e Forcës Punëtore e Riinvestit, Dhjetor 2002)

2.3.2 Shpenzimet Qeveritare në Arsim

Arsimi në Kosovë është kryesisht publik, ndërsa pjesëmarrja e arsimit privat është ende e ulët. Arsimi fillor dhe i mesëm financohet nga grantet e Buxhetit Qendror, të cilat transferohen tek komunat ndërsa arsimi i lartë financohet direkt nga Buxheti i Kosovës dhe nga kontributet e studentëve në formën e pagesës për regjistrim. Arsimi i mesëm privat veçanarisht në kuadër të kolegjeve private të licencuara nga MASHT financohen nga burime private. Universitetin Amerikan i Kosovës poashtu financohet nga fondet private të studentëve që ndjekin këtë universitet. Deri tani nuk është zhvilluar ndonjë mekanizëm që do të mundësonte një portofol më të gjerë të burimeve financiare për arsimin në Kosovë, si p.sh. kombinimi i fondeve private dhe publike, format e ortakërisë dhe përdorimi i burimeve të jashtme të financimit.

Në vendet e zhvilluara, shpenzimet për arsimin fillor dhe të mesëm mbulojnë në masë të madhe nga burimet publike, me rreth 92.8%, me vetëm 7.2% që vijnë nga burimet private. Në këto vende arsimi i lartë financohet nga: burime publike 78.6%, burime private 21.4% dhe 1.9% nga suveccionet. Nëve disa prej vendeve të zhvilluara (si p.sh. SHBA, Korea dhe Japoni) burimet private të financimit dominojnë ndaj burimeve publike. Pjesëmarrje e shpenzimeve publike në arsim si në shpenzimet totale të qeverisë ashtu edhe në Bruto Produktin Vendor (BPV) ndryshon nga vendi në vend. Në vendet e OECD-së pjesëmarrja e të gjitha llojeve të shpenzimeve për arsim në buxhetin total të qeverisë në 1999 ishte 12.7% (8.7% arsimi fillor dhe i mesëm, ndërsa 2,8% për arsimin e lartë). Shpenzimet për arsim si përqindje e BPV-së ishin 5.2% (3.5% arsimi fillor dhe i mesëm dhe 1.2% arsimi i lartë). Shpenzimet për arsim si përqindje e GDP-së në disa vende dhe grupe vendesh paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Comment [n2]: These exceed 100%

Tabela 2: Shpenzimet për arsim si përqindje e BPV-së

	Shpenzimet për arsim / GDP (%)
Vendet e zhvilluar (mesatarja)	4.8
SHBA	5.0
Evropa	5.2
Vendet me të ardhura të ulta	3.2
Vendet me të ardhura të larta	4.7
Bota	4.5

Burimi: Instituti për Burimet Botërore, Tendencat Globale (të dhëna për vitin 1998)

Shpenzimet për arsim në Buxhetin e Kosovës për 2004 llogariten rreth 15% e shpenzimeve totale të buxhetit. Arsimi parashkollor, fillor dhe i mesëm përbëjnë rreth 11.8%, arsimi për nevoja të veçanta 0.18% dhe arsimi i lartë 2.1%.

Tabela 3: Shpenzimet e Qeverisë për Arsim në Kosovë 2000-2004, (në '000 Euro)

	2000	%	2001	%	2002	%	2003	%	2004	%
Ars. Parashk, Fillor dhe i Mesëm	49,493	87.3	52,241	87.0	61,740	83.5	61,444	76.8	72,814	78.6
Inst. arsimore të nevojave të veçanta	642	0.2	469	0.8	816	1.1	956	1.2	1,112	1.2
Arsimi i lartë	6,155	10.9	6,395	10.6	9,891	13.4	11,591	14.5	12,943	14.0
Biblioteka Kombëtare Unversitare	140	0.2	242	0.4	265	0.4	1,125	1.4	1,385	1.5
Administrata arsimore	251	0.4	732	1.2	1,012	1.4	4,499	5.6	2,812	3.0
Trajnimi i mësimdhënësve					192	0.3	230	0.3	1,280	1.4
Zhvillimi i kurrikuleve					65	0.1	200	0.2	273	0.3
Total	56,681	100.0	60,079	100.0	73,981	100.0	80,043	100.0	92,620	100.0
Totali i Buxhetit të Kosovës	285,600		288,20		383,708		556,900		619,000	
% e shp. të arsimit në buxhetin total	20%		21%		19%		14%		15%	

Burimi: MEF

Pagat përbëjnë rreth 85% të shpenzimeve për arsimin fillor dhe të mesëm, kurse për arsimin e lartë një pjesë më e madhe e shpenzimeve ka shkuar për mallra, shërbimeve dhe konsum kapital. Në përgjithësi, kapaciteti i ulët buxhetor për të financuar nevojat e arsimit ka bërë që pagat të jenë të ulta dhe poashtu mundësi të vogla për shpenzime materiale dhe kapitale. Paga mesatare mujore në institucionet e arsimit publik në 2003 ishte rreth 143 €. Ky nivel mbeti i pandryshuar në krahasim me 2002, ndërsa për 2004 është planifikuar një rritje page prej 5%. Shpërndarja e fondeve për arsim sipas destinimeve mund të shihet në tablën e mëposhtme.

Tabela 4: Shpërndarja e fondeve për arsim për paga, mallra, shërbime dhe konsum kapital

Viti	Arsimi Fillor dhe i Mesëm			Universitetet		
	Paga	Mallra & Shërbime	Konsum Kapital	Paga	Mallra & Shërbime	Konsum Kapital
2001	81.0%	15.0%	4.0%	62.0%	38.0%	-
2002	86.5%	4.2%	9.3%	49.6%	42.6%	7.8%
2003	82.6%	14.6%	2.8%	50.0%	41.0%	9.0%
2004	86.4%	11.3%	2.3%	59.0%	36.0%	5.0%

Burimi: Dokumentet e MEF-it

Nevojat financiare të arsimit janë të lidhura me numrin e nxënësve dhe studentëve. Punësimi në arsim zë pjesën më të madhe të punësimit total në institucionet publike. Në 2003 kishte 32,689 veta të punësuar në arsim në Kosovë prej 74,928 të punësuarve në administratën publike. Bazuar në vlerësimet e Institutit për Hulumtje Zhvillimore Riinvest (Anketa e Familjeve dhe Fuqisë Punëtore, dhjetor 2002), numri total i të punësuarve në Kosovë është rreth 430,000 (duke përfshirë sektorin privat, sektorin e administruar nga AKM-ja, organizatat qeveritare, bujqësi, si dhe punësimin informal që konsiderohet deri në 20% të punësimit total). Bazuar në këto të dhëna, punësimi në arsim përbën rreth 6.5% të numrit total të të punësuarve dhe rreth 1.41% të popullsisë totale.

Tabela 5: Punësimi në arsim

	Punësimi në arsim	
	Në punësimin total	Në numrin total të popullsisë
Kosovë (2002)	6.5	1.41
CEE (Evropa Qendrore dhe Lindore)	2.9	1.43
ECA (Evropa Lindore dhe Azia Qendore)	3.3	1.58

Burimi: Banka Botërore (të dhëna për vitin 2000); Riinvest, Raporti mbi Tregun e Punës (2003)

Krahasuar me vendet në tranzicion në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Azinë Qendore, Kosova ka më shumë të punësuar në arsim si përqindje ndaj punësimit total. Të dy këta treguesit të paraqitur në tabelën më lartë flasin për nivel të ulët të punësimit në Kosovë. Për më tepër, ka shenja të një strukture të re moshore të popullsisë në Kosovë, të karakterizuar nga numri në rritje i nxënësve dhe studentëve (425,194 nxënës dhe studentë në 2002/2003).

Sistemi i financimit në Kosovë është treguar joefikas sidomos në arsimin e lartë. Një ndër arsyt është niveli i madh i cetralizimi të vendimmarrjes, sidomos në lidhje me alokimin e fondeve. Në përgjithësi, duhet bërë një transferim më i madh i vendimmarrjes financiare tek shkollat, si dhe duhet fuqizuar transparenca dhe definuar më mirë përgjegjësia. Ende nuk janë ngritur mekanizmat për financimin të qëndrueshëm, të cilat mekanizma do të motivonin institucionet arsimore, mësimdhënësit dhe nxënësit/studentët të synojnë rritjen e rezultateve më të larta në arsim. Në kushtet aktuale shkollat dhe Universiteti shpesh kanë mungesë mjetesh qoftë edhe për financimin e nevojave të tyre më elementare.

⁶ OECD (www.oecd.org/edu/eag2003).

2.3.3 Qeverisja dhe Legjislacioni

2.3.3.1 Arsimi i mesëm – qeverisja dhe legjislacioni

Ligji mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm ka hyrë në fuqi në tetor 2002. Ai parasheh të drejtën për arsim, specifikon qëllimet e arsimit si dhe parimet e mosdiskriminimit dhe përcakton organizimin dhe alokomin e rrjetit shkollor. Ai gjithashtu rregullon përgjegjësitë e Ministrisë, komunave dhe prindërve. Ai kërkon që çdo institucion i financuar nga fondet public të ketë një Bord Shkolle me përfaqësues të zgjedhur nga mësimdhënësit, prindërit dhe në Nivelin 2 e 3 të arsimit në këtë Bord duhet të keetë edhe përfaqësues të nxënësve.

Procesi i decentralizimit të kompetencave mbi arsimin fillor dhe të mesëm ende nuk ka përfunduar: Drejtorët e shkollave ende emërohen zyrtarisht nga MASHT-i (neni 13.5 i LAFM), megjithëse transferimi kompetencave mbi emërimin e mësimdhënësve tek komunat ka hyrë në fuqi që nga data 1 Janar 2003. Drejtori emërohet dhe punësohet sipas rekomandimit të një paneli me përfaqësues të MASHT-it dhe të komunës, ku MASHT ka shumicën. Komuna është përgjegjëse për punësimin dhe pagimin e pagave të administratorëve komunalë të arsimit, personelit arsimor dhe teknik të institucioneve publike. Megjithëse drejtori ka përgjegjësinë si për administrimin akademik dhe të përgjithshëm të shkollës (neni 24.3), ai/ajo nuk është në gjendje të marrë në punë apo të heq nga puna personelin mësimor, pavarësisht nga performansat e tyre. Procedurat e rekrutimit, që ende duhet të zhvillohen nga MASHT, lejojnë pjesëmarrjen e drejtorëve në caktimin e personelit mësimor në shkollat e tyre (neni 32.5); megjithatë ligji nuk ka parashikuar se cilat janë hapat që duhen ndërmarrë nga drejtorët në lidhje me marrjen në punë apo heqjen nga puna të personelit arsimor.

Comment [n3]:

Comment [n4]:

Në kundërshtim me frymën e decentralizimit, vendet e lira të punës jo vetëm për postin e drejtorëve, por edhe për ato të mësuesve shpallen nga MASHT-i (neni 32.4a). Roli i komunave është i kufizuar në përzgjedhjen e personelit jo mësimdhënës. Së këndejmi influenza e komunave në shkollat që janë nën juridiksionin e tyre është e vogël. Duke qenë se ka shumë shkolla fillor dhe të mesme, inspektimi i institucioneve duhet të bëhet rregullisht brenda komunave, nga stafi i zyrës komunale për arsim dhe jo vetëm nga MASHT-i. Sipas ligjit, inspektimi i institucioneve arsimore (dhe nxjerrja e “rekomandimeve për përmirësim”) janë përgjegjësi e MASHT (neni 13.3). Ky ligj nuk ofron një mekanizëm bashkëpunimi në mes MASHT-it dhe komunave në këtë drejtim. Komunat nuk janë të detyruara të kryejnë këto kontrole sipas ligjit ekzistues (megjithatë ato mund të detyrohen me anë të vendimeve administrative), gjë që do të ishte shumë më efektive. Përfshirja e MASHT-it në punët e këtij rangu duket e papërshtatshme, ndërkohë që roli më i përshtatshëm për MASHT do të ishte koordinimi i inspektimeve në komuna të ndryshme që duhen të kryhen nga personeli i tyre.

Roli i MASHT në licencimin e institucioneve private të arsimit është definuar mirë (neni 41.1). Kriteret bazë janë formuluar por ato duhet të përcaktohen më tej në detaje në akte administrative. Ajo që është shqetësuese është që komunat (dhe inspektorët e tyre) nuk luajnë ndonjë rol gjatë veprimtarisë së shkollës. Komunat duhet të përfshihen në monitorimin e veprimtarisë së institucionit, spese MASHT-it nuk ka kaëacitete të mjaftueshme për të përcjellur zhvillimet në çdo shkollë private në vend.

2.3.3.2 Arsimi i lartë – qeverisja dhe legjislacioni

Ligji mbi Arsimin e Lartë është aprovuar në Maj 2003 dhe është hartuar në pajtim me zhvillimet më të fundit në sistemet evropiane të arsimit të lartë. Në mënyrë të veçantë ai përcakton detyrimin që sistemi i lartë arsimor i Kosovës të zhvillohet në drejtim të qëllimeve të vendosura nga procesi i Bolonjës. Ndërkohë dy Udhëzime Administrative që rregullojnë Agjencinë për Akreditim të Kosovës (AAK) dhe liçencimin e institucioneve private sigurojnë bazat fillestare për ngritjen e mekanizmave të garantimit të cilësisë në arsimin e lartë. Senati i Universitetit të Prishtinës në shtator 2003 ka hartuar një statut të ri në pajtim me këto udhëzime, megjithëse ky ende pritet aprovimi nga MASHT.

Ligji i ri është në frymën e procesit të Bolonjës si dhe është i ngjashëm me ligjet që janë në fuqi në vendet e tjera në tranzicion. Ligji ka një karakter shumë të përgjithshëm, duke ia lënë formulimet e detajuara statuteve të institucioneve të arsimit të lartë, si dhe akteve dhe rregulloreve që duhet të nxirren nga MASHT-ti. Nga kjo perspektivë, është veçanërisht e rëndësishme studimi i raporteve midis ligjit dhe statutit të Universitetit të Prishtinës. Këto raporte janë të rëndësishme posaqërisht me shfaqjen e institucioneve të reja të arsimit të lartë qoftë publike apo private.

Boksi 2: Definimi i studimet me korespondencë në Ligjin e Arsimit të Lartë

Një prej çështjeve më të rëndësishme nga perspektiva e rritjes së pjesëmarrjes në arsimin e lartë në kushtet e kufizimeve aktuale financiare dhe të mungesës së sektorit privat është pranimi i studentëve me korespondencë (në fundjavë, mbrëmje, etj). Ligji i ri është i qartë në këtë drejtim: neni 2.5 thekson se “Arsimi i lartë mund të kryhet me kohë të plotë ose të pjesshme, si mësim në distancë dhe në çdo kombinim të këtyre modeleve të studimit siç parashikohet në statutin e institucionit që ofron arsim të lartë”. Fatkeqësisht statuti i ri që i është dërguar Ministrisë për aprovim, duke ndjekur politikën më të fundit të *mos pranimit* të studentëve me korespondencë, nuk është aq i qartë sa ligji. Në nenin 96 ai thekson se “studimet mund të ndiqen me shkëputje nga puna, pa shkëputje nga puna, në distancë dhe në çdo kombinim tjetër të këtyre formave të studimit”. Është e vështirë të thuhet sesi mund të bëhet lidhja mes studimeve me kohë të plotë dhe të pjesshme me “punësimin” në një vend ku papunësia e të rinjve është mbi 70%.

Për qeverisjen dhe menaxhimin e institucioneve publike të arsimit të lartë, statuti i institucionit është shumë i rëndësishëm. Siç shihet edhe nga Ligji (kapitulli 4, seksioni 13), roli i Ministrisë në lidhje me statutin e institucionit publik mund të jetë relativisht i pafavorshëm. Mungesa të një legjislacioni më gjithëpërfshirës për arsimin e lartë në nivel qëndror mund të rezultojë në definime të ndryshme të të njëjtave çështje në statute të ndryshme. Statuti duhet të garantojë disa parime të përgjithshme (p.sh barazia e mundësive në punësim dhe qasje e barabartë në studime dhe hulumtime etj.). Pas përgaditjes, statuti aprovohet nga MASHT-i “nëse plotëson kushtet e përcaktura me ligj”. Në rast të refuzimit nga ana e Ministrisë, ose kërkesës për modifikime në të, mund të bëhet ankim në gjykatën e juridiksionit kompetent” (neni 13.6). Ministria mund të influencoi në përgaditjen e statutin nëpërmjet të anëtarëve të saj në Bordin e Universitetit.

3. ARSIMI I MESËM DHE I LARTË NË KOSOVË: SITUATA AKTUALE DHE VLERËSIMI

3.1 Struktura aktuale e shkollimit – Struktura e re organizative

Kosova tani ka sistemin 5 + 4 +3 të shkollimit që fillon prej moshës 6 vjeçare. Ndërrimet strukturale të kohëve të fundit janë futur me qëllimin për ta bërë sistemin arsimor kosovar kompatibil me sistemet arsimore në vendet e BE-së dhe të vendeve të zhvilluara. Struktura arsimore në Kosovë tani përbëhet prej : (i) Arsimit parashkollor; (ii) Arsimit fillor; (iii) Arsimit të mesëm; dhe (iv) arsimit të lartë (fakultete dhe studime pasdiplomike).

Tabela 6: Struktura e re e sistemit arsimor në Kosovë (MASHT)

Niveli i arsimit	Mosha	Standardet Ndërkombëtare të Klasifikimit të Arsimit (SNKA)
Arsimi parashkollor	3-5	ISCE 0
	5-6	
Arsimi fillor	6-7	ISCE 1
	7-8	
	8-9	
	9-10	
	10-11	
Arsimi i mesëm i ulët	11-12	ISCE 2
	12-13	
	13-14	
	14-15	
Arsimimi i mesëm i lartë (Gjimnazet dhe shkollat profesionale)	15-16	ISCE 3
	16-17	
	17-18	
Arsimi i lartë	19-	

(i) Arsimimi parashkollor: Përbëhet prej dy cikleve: kujdesi në foshnjore (kopsht) dhe arsimimi parashkollor në foshnjore. Fëmija mund të ndjekë foshnjoren qysh prej moshës 9 muajsh. Megjithatë, kujdesi nuk konsiderohet si arsimor, deri sa fëmija të jetë tre vjeç. Për rrjedhojë, kujdesi në foshnjore mbulon fëmijët e moshave prej tre deri në pesë vjeç, derisa arsimimi parashkollor përfshin ata prej pesë deri në gjashtë vjeç. Arsimimi parashkollor nuk është i obliguar. Numri i përgjithshëm i fëmijëve në arsimin parashkollor në vitin 2002/2003 ka qenë **22,498** (52.5% meshkuj, 47.5% femra), derisa numri i përgjithshëm i të punësuarve në këto institucione ka qenë **1003** veta. Prej tyre 84% kanë qenë mësues dhe pjesa tjetër personel administrativ.

Duke shfrytëzuar të dhënat e Anketës së Riinvestit për Familjet dhe Fuqinë Punëtore (Dhjetor 2002) për të identifikuar grupmoshat e popullatës⁷ prej 0-6 vjeç (që është 12.6% e numrit të gjithëmbarshtëm të popullatës që jeton në Kosovë – 2,050,000) dhe numrit të fëmijëve parashkollorë të regjistruar në 2002/2003 prej 22,498, kemi llogaritur një shkallë pjesëmarrje në arsimin parashkollor që është 8.7%. Qendra për Arsim e Kosove (2002, f.74) vlerëson se kjo pjesëmarrje është 4.9%. Këto dallime ka të ngjarë të jenë rrjedhojë e dallimeve në numrin e popullatës të shfrytëzuar për të kalkuluar këtë normë. Banka Botërore (2002, f.67) që jep një normë prej 10% pjesëmarrjeje në arsimimin parashkollor në Kosovë, ngrit shqetësimin e pjesëmarrjes shumë të ulët të fëmijëve nga rradhët e familjeve me të ardhura të ulta.

⁷ Popullata e Kosovës llogaritet të jetë 2.5 milionë, me 2.05 milionë që banojnë në Kosovë (Raporti i Riinvestit 2003)

(ii) Arsimit fillor – nga viti shkollor 2000/2001⁸ moshë për fillimin e arsimit fillor të detyruar ka ndërruar prej moshës 7 vjeçe sa ka qenë përparë në moshën 6 vjeçare, përderisa kohëzgjatja e arsimit të detyrueshëm është zgjatuar prej tetë në nëntë vite. Para kësaj periudhe arsimiti i detyrueshëm ka qënë i bazuar në modelin 4 + 4, të përbërë prej dy cikleve: cikli i klasëve të ulta apo klasëve edukative dhe cikli i klasëve të larta apo klasëve lëndore. Në ciklin e parë mësimi i të gjithë fëmijëve është bërë nga një mësimdhënës i vetëm, derisa në ciklin e dytë ka pasur mësimdhënës të specializuar për një lëndë.

Në strukturën e arsimit të detyruar përbehet prej dy cikleve: arsimit fillor, që zgjat pesë vjet, dhe arsimit të ulët të mesëm që zgjat katër vjet. Në sistemin ekzistues edukativ nuk ka ndarje formale midis arsimit fillor dhe atij të ulët të mesëm, ndërsa të dhënat statistikore të arsimit fillor i referohen edhe arsimit fillor edhe atij të mesëm të ulët. Arsimit fillor ofrohet në shkolla kryesore dhe satelite. Në vitin shkollor 2002/2003⁹ kanë qenë 973 shkolla fillore në total, dhe në 86.8% prej tyre mësimi është mbajtur në shqip, 9.4% në serbisht, 2.4% në gjuhën boshnjake, 0.3% në gjuhën gorane, një shkollë përdor gjuhën turke, dhe në 10 prej tyre mësimi bëhet në disa gjuhë. Nga numri i përgjithshëm i personelit në arsimit të detyruar (20,352), mësimdhënësit përbëjnë 81%, 5% personel administrativ, ndërsa 13% janë asistentë.

Është e vështirë të llogaritet norma e pjesëmarrjes në arsimin e detyruar dhe arsyeja kryesore për këtë është mungesa e të dhënave të sakta për numrin e popullsisë. Një studim i kryer nga Banka Botërore¹⁰ ka treguar se regjistrimi në arsimin fillor është gati se universal dhe arrin në shkallën 97%. Ai studim tregon se ka dallime midis grupeve të ndryshme etnike (vetëm 77% të fëmijëve që u përkasin grupeve etnike jo-shqiptare dhe jo-serbe janë të regjistruar në shkollimin e detyruar). Duke përdorur të dhënat nga Anketa e Riinvestit për Familjet dhe Fuqinë Punëtore të përmendur më lartë (sipas të cilës grupmosha 7-14 vjeçe përbën 17.5% të popullatës së gjithëmbarshme të Kosovës prej 2.05 milionë) dhe numrin prej 315,089 nxënësve të regjistruar në arsimin e detyruar në vitin shkollor 2002/2003, norma e pjesëmarrjes llogaritet të jetë rreth 88%. Edhe në këtë rast, dallimet janë si pasojë e numrit të popullsisë të përdorur për të llogaritur këtë shkallë. OECD (2001) madje jep një normë më të ulët të pjesëmarrjes në arsimin fillor (afërsisht 80%).

(iii) Arsimit mesëm – Arsimit mesëm (i lartë) në Kosovë përbëhet prej gjimnazëve (drejtim i përgjithshëm) dhe shkollave profesionale që zgjasin tri ose katër vite. Drejtimet e përgjithshme janë ato shkolla të cilat ofrojnë arsimim të përgjithshëm që ka për qëllim përgjithshësisht të zhvillojë aftësitë akademike të studentëve dhe t'i përgadis ata për arsimim universitar. Janë katër lloje të shkollave të përgjithshme në Kosovë: (i) Shkollat e përgjithshme, (ii) Shkollat e përgjithshme me dy drejtime (sociale – gjuhë dhe shkenca natyrore dhe matematiko-natyrore), (iii) Shkollat e përgjithshme pedagogjike (iv) Shkollat e specializuara në gjuhët e huaja. Shkollat profesionale (të zanatit) zgjasin tre deri në katër vjet. Shkollat e mesme katër-vjeçare i përgatisin studentët për punë ose për studime të mëtejme, derisa ato tre-vjeçare i përgatisin studentët vetëm për punë.

Bazuar në të dhënat që janë në posedim në vitin shkollor 2002/2003 kanë qenë 140 shkolla të mesme. Në 72.5% të tyre mësimi është mbajtur në shqip, në 22% serbisht, në 4,5% mësimi mbahet në më tepër se një gjuhë, dhe në një shkollë të mesme mësimi mbahet në gjuhën turke (0.7%). Numri i përgjithshëm i nxënësve në arsimin e mesëm është 86,830 (55.1% meshkuj). Sipas grupimit etnik, 90.8% të nxënësve të regjistruar janë shqiptarë, 7.9% serbë dhe 1.3% prej minoriteteve të tjera. Norma e pjesëmarrjes në arsimin e mesëm varion sipas burimit të të dhënave të përdorur për të kalkuluar atë. OECD (2001) thotë se kjo normë për grup-moshat 16-18 vjeç

⁸ Vendimi është marrë nga Këshilli i Përkohshëm Administrativ, me sugjerime të DEST.

⁹ Të dhënat statistikore për arsimin në Kosovë, 2002/2003, Shtator 2003, MASHT/BB/EMIS

¹⁰ The Living Standard Measurement Survey; World Bank (2001): Kosovo Poverty Assessment. Volume I

është 37-38%. Banka Botërore (2001), bazuar në anketën LSMS, llogarit normën e pjesëmarrjes të moshave 15-18 vjeç si vijon: shqiptarë 65%, serbë 90% dhe grupet tjera etnike 46.4%.

(iv) **Arsimimi i Lartë (universitare dhe pas-universitare)** – Universiteti i Prishtinës është institucioni dominant i arsimit të lartë në Kosovë, i përbërë prej 22 fakulteteve dhe shkollave të larta si vijon:

Tabela 7: Numri i studentëve në UP (2002/2003) dhe numri i studentëve të diplomuar (1991-2002)

Nr.	Fakultetes/Shkollat e Larta (2002/2003)	Studentë	%	Viti Akademik	Numri i studentëve të diplomuar
1	F. i Filozofisë	1,865	8.0%	1991/ 92	1,122
2	F. i Shkencave Matematiko-Natyrore	1,697	7.3%	1992/ 93	1,190
3	F. i Filologjisë	2,282	9.8%	1993/ 94	1,177
4	F. Juridik	2,987	12.9%	1994/ 95	1,106
5	F. Ekonomik	2,965	12.8%	1995/ 96	1,002
6	F. i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	1,100	4.7%	1996/ 97	1,363
7	F. Elektro-Teknik	1,075	4.6%	1997/ 98	1,392
8	F. i Makinerisë	739	3.2%	1998/ 99	827
9	F. i Mjekësisë	1,885	8.1%	1999/ 2000	1,617
10	F. i Arteve	567	2.4%	2000/ 2001	2,077
11	F. i Bujqësisë	472	2.0%	2001/ 2002	2,375
12	F. i Xehitarisë dhe Metalurgjisë	300	1.3%	Total	15,248
13	F. i Kulturës Fizike	377	1.6%		
14	F. i Mësuesisë	199	0.9%		
15	F. i Edukimit	323	1.4%		
16	Shkolla e Lartë Pedagogjike Prishtinë	1,378	5.9%		
17	Shkolla e Biznesit në Pejë	472	2.0%		
18	Shkollat e Larta Teknike në Mitrovicë	510	2.2%		
19	Shkolla e Lartë Pedagogjike, Prizren	742	3.2%		
20	Shkolla e Lartë Pedagogjike, Gjakovë	586	2.5%		
21	Shkolla e Lartë Pedagogjike, Gjilan	595	2.6%		
22	Shkolla e Lartë Teknike, Ferizaj	59	0.3%		
Total		23,175	100.0%		
	Fakulteti	18,833	81.3%		
	Shkolla të Larta	4,342	18.7%		
	Total	23,175	100.0%		

Burimi: <http://www.uni-pr.edu/statistikat.html>

Numri i përgjithshëm i studentëve të rregullt në Universitetin e Prishtinës në vitin akademik 2002/2003 ka qenë 23,175¹¹ (59% prej tyre kanë qenë meshkuj). Fakulteti Juridik është më i madhi (2,987 studentë) i pasuar me Fakultetin Ekonomik (2,965). Qysh prej se është themeluar Universiteti i Prishtinës, më shumë studentë kanë qenë të orientuar drejt studimit në shkencat shoqërore dhe humane sesa ato në shkencat e natyrës, teknike dhe të matematikës. Në vitin akademik 1969/70, 68.7% e studentëve kanë qenë të përfshirë në drejtimet e lartpërmenduar, përqindje kjo që është rritur në 74.6% në vitin akademik 1980/81. Pas reformave është arritur një distribuim më i balancuar dhe në vitin akademik 1988/89 54% e studentëve kanë ndjekur ligjeratat në shkencat natyrore dhe në drejtime teknike. Në dekadën e fundit, është shënuar sërish një rritje në numrin e studentëve të cilët studiojnë në shkencat shoqërore dhe humane.

Në vitin akademik 2002/2003 numri total i personelit të Universitetit ka qenë 952, prej të cilëve 615 kanë qenë duke punuar me orar të plotë. Personeli akademik përbëhet kryesisht prej meshkujve dhe shumica e profesorëve kanë gradë shkencore të doktorit të shkencave. Tabela e mësipërme paraqet të dhënat për numrin e të diplomuarve prej Universitetit të Prishtinës gjatë

¹¹ <http://www.uni-pr.edu/statistikatgrafik.html>

viteve të 90'ta dhe në periudhën prej dy vitesh pas lufte. Bie në sy rritja e numrit të të diplomuarve në raport me numrin e përgjithshëm të studentëve në dy vitet e fundit.

Arsimi pasuniversitar në Kosovë është rregulluar me një dekret-ligj për Arsimin e Lartë Nr. 20/94, me 29 Qershor 1994, miratuar prej Qeverisë së Përkohshme të Kosovës. Studimet për Magjistër të Shkencave zgjasin dy vjet, kurse ato për Doktoraturë zgjasin së paku tri vite. Aktualisht, nuk ofrohen studime profesionale apo doktorature në baza të rregullave në Universitetet.

3.2 Vlerësim mbi gjendjen në sistemin e arsimit: Anketat e Riinvestit

Në disa raporte të mëparshme mbi sistemin e edukimit në Kosovë të përgaditura nga Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD 2003a) janë paraqitur karakteristikat kryesore dhe dobësitë e këtij sistemi para implemetimit të reformave. Vlerësim përgjithshëm i sistemit të arsimit në Kosovë ishte se regjistrimi në arsimin parashkollor ishte i ulët, arsimi fillor karakterizohej me shkallë të lartë të mungesës së nxënësve apo të mosvijimit të rregullt të mësimi dhe pjesëmarrje në përgjithësi të ulët në arsimin e mesëm dhe të lartë. Gjendja e keqe e pajisjeve dhe e ndërtesave ku zhvillohej procesi arsimor dhe pagat e ulëta të mësimit dhe profesorëve bashkë me mungesën e trajnimit të duhur për ta ka rezultuar në një situatë ku shumica e tyre kanë mbajtur nga disa vende pune dhe në një proces të ngadalshëm të zbatimit të planprogrameve (kurrikuleve) të reja dhe metodologjisë moderne të mësimit dhe mësimit nxënës. Sistemi i mëparshëm i arsimit nuk kishte një njësi qendrore të evaluimit të performansave dhe se të gjitha përgjegjësitë në lidhje me këtë vlerësim i kishin shkollat/fakultetet. Nuk kishte standarde të vëna në lidhje me këtë vlerësim të cilat do të mundësonin krahasimin e performansave në mes shkollave dhe brenda shkollës – në mes të mësimit dhe nxënësve. Studimet e rregullta në nivel universitar kanë zgjatur në minimum 4 vite, dhe se në vitin 1999/2000 (menjëherë pas lufte) kanë diplomuar rreth 1600 studentë (rreth ¼ e tyre kanë diplomuar në shkenca natyrore dhe teknike). Kjo normë e ulët e diplomimit, bashkë me kohën e gjatë të kompletimit të studimeve dhe normë të lartë të braktisjes së studimeve, kanë qenë karakteristika që e kanë përcjellur punën e Universitetit të Prishtinës (UP). Pagesat për semestër në UP janë aplikuar në vitin 2002/2003. Poashtu kanë filluar edhe reformat strukturore dhe të kurrikuleve sipas Deklaratës së Bolonjës..

Duke përdur të dhënat nga anketat dhe intervistat që Instituti Riinvest ka zhvilluar në kuadër të këtij projekti, është paraqitur një vlerësim i performansave aktuale të sistemit të arsimit.

3.2.1 Objektivat dhe metodologjia e hulumtimit

Me qëllim që të mbledh të dhëna mbi sistemin e arsimit, ekipi i Riinvestit ka dizajnuar, testuar dhe implementuar këto anketa dhe intervista:

- (i) Anketë me 100 mësimit dhe nxënës të shkollave të mesme dhe 92 ligjërues universiteti,
- (ii) Anketë me 375 studentë të universitetit,
- (iii) Intervista gjysmë të strukturuar me 19 drejtorë të shkollave të mesme në të gjithë Kosovën dhe 8 dekanë të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës (UP)

Përmes pyetjeve nën (i) dhe (ii) është kërkuar të sigurohen informata mbi mënyrën se si po zhvillohet procesi mësimor dhe cili është mendimi i studentëve në lidhje me cilësinë e studimeve (të cilët së shpejti do hyjnë në tregun e punës). Studentët e anketuar kanë qenë studentë të vitit të fundit të studimeve. Të dhënat nga këto hulumtime kanë mundësuar që të jepet një vlerësim për reformat që janë duke u implemetuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) dhe Rektorati i Universitetit si dhe të sigurojnë informata se si po funksionon sistemi i

arsimit në përgjithësi. Në vijim po përshkruajmë metodologjinë e hulumtimit për anketat e zhvilluara dhe intervista gjusëm të strukturuar.

(i) Anketa me mësimdhënës të shkollave të mesme dhe të Universitetit

Mostra për këtë anketë ka përfshirë 100 mësimdhënës të shkollave të mesme dhe 92 mësimdhënës universitar. Mësimdhënësit e intervistuar/anketuar janë zgjedhur sipas metodës së zgjedhjes së rastësishme nga numri i përgjithshëm i mësimdhënësve në shkollën përkatëse. Mënyra se si janë zgjedhur shkollat e mesme dhe fakultetet/shkollat e larta nga të cilat pastaj janë zgjedhur mësimdhënësit për t’u intervistuar është shpjeguar më poshtë.

Mostra e shkollave të mesme: Për të vedosur për shkollat e mesme (SHM) nga të cilat do të intervistoheshin mësimdhënësit janë përdorur të dhënat e MASHT-it¹². Në tabelën e mëposhtme është paraqitur popullacioni i shkollave të mesme (gjithsej 72 shkolla) si dhe mostra e cila është e shpërndarë në mënyrë proporcionale sipas llojit të shkollës. Në secilën shkollë janë anketuar nga 5 mësimdhënës.

Tabela 8: Popullacioni dhe mostra e shkollave të mesme të përfshirë në hulumtim

Lloji i SHM	Popullacioni		Mostra			
	Nr. i shkollave	%	Nr. i shkollave	Nr. i mësimdhënësve për shkollë	Nr. i mësimdhënësve për tu intervistuar për secilin lloj të shkollave të mesme	%
Gjimnaze	25	35%	7	5	35	35%
Ekonomike-Juridike	11	15%	4	5	20	15%
Teknike	18	25%	5	5	25	25%
Bujqësi	3	4%	1	5	5	5%
Art & Muzikë	7	10%	1	5	5	10%
Mjekësi	8	11%	2	5	10	10%
Gjithsej	72	100%	20		100	100%

Burimi: MASHT (2003): Të dhëna statistikore mbi arsimin në Kosovë, 2002/2003; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shtator 2003

Duke e përdorur teknikën e zgjedhjes së rastësishme, shkollat e mesme së pari janë stratifikuar sipas llojit (të paraqitur në tabelën më lartë), dhe pastaj janë zgjedhur këto shkolla:

- Gjimnaze (7) (Mitrovicë, Gjakovë, Skenderaj, Prishtinë, Shtërpc, Lipjan, Viti)
- Ekonomike-Juridike (4) (Gjilan, Kamenicë, Fushë Kosovë, Prizren)
- Teknike (5) (Suharekë, Mitrovicë, Obiliq, Prishtinë, Prizren)
- Bujqësi (1) (Ferizaj)
- Art dhe Muzik (1) (Pejë)
- Mjekësi (2) (Prishtinë, Kamenicë)

Mostra në Universitet: Mostra në Universitet ka konsistuar prej 92 mësimdhënësish të fakulteteve dhe shkollave të larta (të paraqitur në tabelën më poshtë). Shpërndarja e mostrës së mësimdhënësve në fakultete dhe SHM është proporcionale me numrin e studentëve. Poashtu në mostër janë përfshirë edhe dy institucione private të arsimit të lartë në Kosovë: Kolegji i Arteve dhe Shkencave Shoqërore dhe Universiteti Amerikan i Kosovës.

¹² Burimi: MASHT (2003): Të dhëna statistikore mbi arsimin në Kosovë, 2002/2003; Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Shtator 2003

Tabela 9: Mostra e mësimdhënësve universitar

Nr.	Fakulteti/Shkolla e Lartë	Nr. i mësimdhënësve për tu anketuar	%
1	F. Filozofik	7	7.6%
2	F. të Shkencave të Natyrës	6	6.5%
3	F. Filologjik	8	8.7%
4	F. Juridik	11	12.0%
5	F. Ekonomik	11	12.0%
6	F. Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	4	4.3%
7	F. Elektroteknik	4	4.3%
8	F. të Makinerisë	3	3.3%
9	F. të Mjekësisë	7	7.6%
10	F. të Arteve	2	2.2%
11	F. të Bujqësisë	2	2.2%
12	F. Xehetar-Metalurgjik	1	1.1%
13	F. i Kulturës Fizike	1	1.1%
14	F. i Mësuesisë	1	1.1%
15	F. i Edukimit	1	1.1%
16	Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë	5	5.4%
17	Shkolla e Biznesit në Pejë	2	2.2%
18	Shkolla e Lartë Teknike në Mitrovicë	2	2.2%
19	Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prizren	3	3.3%
20	Shkolla e Lartë Pedagogjike në Gjakovë	2	2.2%
21	Shkolla e Lartë Pedagogjike në Gjilan	2	2.2%
22	Shkolla e Lartë Teknike në Ferizaj Ferizaj	1	1.1%
23	Kolegji i Arteve dhe Shkencave Sociale	3	3.3%
24	Universiteti Amerikan i Kosovës	3	3.3%
TOTAL		92	100.0%

(ii) Anketa me studentë të Universitetit

Pas disa konsultimeve që bëri ekipi i projektit, u vendos që mostra prej 375 studentëve është e mjaftueshme për të fituar informata mbi opinionet e studentëve në lidhje me cilësinë dhe mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor. Janë intervistuar vetëm studentët e vitit të fundit të studimeve pasi ata pritet që shumë shpejt të hyjnë në tregun e punës dhe mund të vlerësojnë më mirë ecurinë e reformave. Poasht janë intervistuar edhe 30 studentë nga dy institucionet private të arsimit të lartë (nga 15 në secilën): Kolegji i Arteve dhe Shkencave Shoqërore dhe Universiteti Amerikan i Kosovës. Shpërndarja e mostrës është paraqitur më poshtë. Mostra në Fakultet dhe SHL të Universitetit të Prishtinës është proporcionale me numrin e studentëve që studiojnë në to, por nuk janë përfshirë të gjitha Fakultetet dhe SHL. Kjo për arsye se disa nga Fakultetet dhe SHL janë specifike për nga natyra e studimit, prandaj korrelacioni i tyre me ekonominë nuk është i madh në krahasim me ato fakultete të cilat janë marrë në konsiderim.

Tabela 10: Shpërndarja e mostrës në anketën me studentë

Nr. Fakulteti/Shkolla e Lartë	Nr. i studentëve për tu intervistuar		Mostra/Popullacioni
1 F. Filozofik	25	6.7%	0.01
2 F. i Shkencave Matematike-Natyrore	25	6.7%	0.02
3 F. i Filologjisë	25	6.7%	0.01
4 F. Juridik	40	10.7%	0.01
5 F. i Ekonomisë	40	10.7%	0.01
6 F. i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	20	5.3%	0.02
7 F. Elektroteknik	20	5.3%	0.02
8 F. i Makinerisë	20	5.3%	0.03
9 F. i Mjekësisë	20	5.3%	0.01
10 F. i Bujqësisë	20	5.3%	0.04
11 F. of Xehetar-Metalurgjik	15	4.0%	0.05
12 F. i Edukimit	15	4.0%	0.05
13 Shkolla e Lartë Pedagogjike në Prishtinë	15	4.0%	0.01
14 Shkolla e Biznesit në Pejë	15	4.0%	0.03
15 Shkolla e Lartë Teknike në Mitrovicë	15	4.0%	0.03
16 Shkolla e Lartë Teknike në Ferizaj	15	4.0%	0.25
17 Kolegji i Arteve dhe Shkencave Sociale	15	4.0%	0.25
18 Universiteti American i Kosovës	15	4.0%	0.24
GJITHSEJ	375	100.0%	0.02

(iii) Intervistate e thella me Drejtorë të SHM dhe me Dekanët në kuadër të UP

Intervistat me Drejtorët e Shkollave të Mesme në Kosovë: Qëllimi i këtyre intervistave ishte që të analizohet më për së afërmi procesi mësimor në SHM. Janë intervistuar gjithsej 19 Drejtorë të SHM dhe janë përfshirë të gjitha llojet e shkollave të mesme. Në fakt, këtu janë intervistuar Drejtorë e atyre shkollave të mesme të zgjedhura për anketë me mësimdhënës (*shih pikën (i) më lartë*).

Intervistat me Dekanët e 8 Fakulteteve në UP: Pyetjet në këtë intervistë kanë qenë të natyrës së njëjtë si me drejtorë të shkollave të mesme, por me theks në punën e Fakulteteve. Në veçanti është diskutuar procesi i reformave sipas Deklaratës së Bolonjës si dhe qështje që kanë të bëjnë me menxhimin dhe vendim-marrjen, motivimin e mësimdhënësve si dhe problemet e tjera relevantet që ballafaqohen Fakultetet.

3.2.2 Rezultatet e hulumtimit: Arsimi i Mesëm

Në këtë pjesë janë paraqitur rezultatet kryesore nga këto hulumtime (anketa dhe intervista):

- *Intervistat e thella me Drejtorë të SHM në Kosovë:* Qëllimi i këtyre intervistave ishte që të analizohet situata në arsimin e mesëm. Qëshjtjet që janë diskutuar kanë përfshirë: procedurat e vendim-marrjes, financimi, zhvillimi i stafit, informimi i prindërve dhe involvimi i tyre në vendim-marrje në shkolla etj. Janë intervistuar gjithsej 19 mësimdhënës prej të gjitha llojeve të shkollave të mesme (si gjimnaze ashtu edhe shkolla të mesme profesionale).
- *Anketa me 100 mësimdhënës në shkolla të mesme:* Me anë të kësaj ankete janë siguruar të dhëna mbi: (i) metodologjinë/procesin mësimor; (ii) disponimi me literaturë përkatëse dhe pajisje kompjuterike; (iii) planprogramin; (iv) suksesin e nxënësve, mungesat, përrsëritja e vitit; dhe (v) stafin mësimdhënës.

Vlerësime të përgjithshme

- Rreth 43% të stafit mësimdhënës në shkollat e mesme janë të moshës 41-50 vjeç. Shumica e stafit mësimdhënës (92%) kanë diplomë universtare – kanë mbaruar studimet e rregullta;
- Numri mesatar i nxënësve për një shkollë është rreth 932, prej të cilëve rreth 37% janë femra (këtë përqindje është më e lartë në gjimnaze),
- Sikurse edhe në vendet tjera në tranzicion, në vitin shkollor 2003/2004 është rritur numri i nxënësve në gjimnaze, në arsimin e mesëm të përgjithshëm, krahasuar me dy vite më parë. Kjo poashtu është reflektuar edhe në numrin e aplikantëve për një vend në gjimnaze (mesatarisht 3 veta aplikojnë për një vend);
- Norma e përsëritjes së vitit dhe e mungesës në mësim sillet rreth 5%. Të dyja këto norma janë më të ulta në gjimnaze;
- Rreth 90% e nxënësve që kanë regjistruar shkollën e mesme sivjet pritet të mbarojnë/të diplomojnë me kohë. Kjo përqindje është më e ulët për shkollat e mesme profesionale;
- Madhësia mesatare e klasës sillet nga 26 deri në 31 nxënës për klasë,
- Numri mesatar i kompjuterëve për shkollë është 14, që rezulton se rreth 67 nxënës përdorin një kompjuter;
- Shumica e shkollave punojnë në dy ndërrime si rezultat i mungesës së hapësirës/objektit të mjaftueshme për mësim;
- Numri mesatar i mësimdhënësve për shkollë me kohë të plotë të punës është rreth 61 (norma javore e punës është 20 orë në javë), që jep një raport prej 15 nxënës për 1 mësimdhënës;

Tabela 11: Disa rezultate kryesore nga intervista me Drejtorët e Shkollave të Mesme

Lloji i shkollës së mesme	Nr. mesatar i nxënësve për shkollës	% femrave	Rritja (në %) e numrit të nxënësve në vitin 2003/2004 krahasuar me dy vite më parë	Numri i aplikantëve e për një vend në SHM (mesatarja)	Përqindja mesatare e nxënësve që kanë përsëritur vitin shkollor më 2001/2002	Përqindja mesatare e nxënësve të regjistruar sivjet që priten të diplomojnë me kohë	Përqindja mesatare e nxënësve që mungojnë gjatë një dite të rëndomtë mësimi	Madhësia mesatare e klasës	Numri mesatar i kompjuterëve për shkollë	Numri mesatar i stafit me kohë të plotë të punës për shkollë	Përqindja mesatare e mësimdhënësve për shkollë që kanë mbaruar trajnimin fillestar për mësimdhënës
Bujqësore	684	18%	145	0.3	0.5%	88	10	26	3	48	30
Ekonom-Juridike	784	46%	28	2.7	10.5%	86	4	29	15	53	25
Gjimnaz	962	49%	13	2.9	4.4%	94	4	31	19	65	47
Teknike	1,071	22%	-8	3.3	6.0%	87	5	28	9	64	17
Total	932	37%	25	2.8	5.5%	90	5	29	14	61	33

Burimi: Anketa me mësimdhënës të shkollave të mesme dhe intervistat me Drejtorë të shkollave të mesme

Sukesi/performansat në procesin mësimor

Në objektivat strategjike të gjimnazeve mbizotëron qëllimi për përgaditjen e nxënësve për arsimin e lartë, derisa shkollat e mesme profesionale theksojnë rolin e tyre në përgaditjen e nxënësve për tregun e punës. Të gjitha shkollat e mesme që i kemi vizituar janë të preokupuara me procesin aktual të reformave. Megjithë përgaditjen që ka bërë MASHT për klasën e 10, e cila ka filluar të në vitin 2003/2004, në shumicën e shkollave ndihet një mungesë e teksteve mësimore për këtë klasë dhe përgaditje e pamjaftuar për klasën e 11 dhe 12.

Indikatorët për matjen e performansave të shkollave dhe krahasimin në mes tyre nuk janë të zhvilluar. Sistemi Informatik për Menaxhimin e Arsimit (SIMA), që është duke u implementuar nga Banka Botërore, është koncentruar në zhvillimin e procedurave për mbledhjen e të dhënave për nxënësit sipas shkollave, për shkallën e përfshirjes në arsim dhe vijimin e rregullt të procesit mësimor. Deri më tani MASHT, komunat dhe shkollat nuk disponojnë me të dhëna mbi suksesin e nxënësve të provimit pranuese në Universitet dhe as për shkallën e punësimit të tyre. Për të matur efikasitetin intern të shkollës zakonisht përdoren të dhëna mbi suksesin e nxënësve në fund të vitit, të dhënat mbi mungesat, numri i atyre që përsërisin vitin, disiplina në mësim etj. Është me rëndësi të theksohet se të dhënat që mbledhen nuk përdoren për caktimin e objektivave të shkollave në procesin e vendim-marrjes. Për shembull, shkollat nuk kanë një objektiv të qartë dhe as strategji dhe politika për të zvogëluar shkallën e mungesave të nxënësve për një periudhë afatshkurtër apo afatmesmenë një periudhë të caktuar kohore (të themi prej $x\%$ në $y\%$ deri në vitin z). Kështu “Plani i Zhvillimit të Shkollës” është vetëm si një dokument për të identifikuar aktivitetet e brendshme të shkollës. Ky plan është thjesht indkativ dhe nuk parasheh objektiva të qarta që duhet të arrihen brenda një periudhe të caktuar kohore. Për më tepër nuk ka një mekanizëm të zhvilluar që do të ofronte informata në lidhje me atë se në çfarë mase është realizuar ky plan.

Boksi 3: Shkollat po orientohen gjithmonë e më shumë ndaj tregut

Shkolla e Mesme e Bujqësisë në Prishtinë është ballafaqur me rënien e kërkesave për regjistrim në këtë shkollë. Përgjigja e shkollës ndaj kësaj dukurie ishte prezantimi i një modeli të ri të kurrikulës dhe përdorimi i fondeve në dispozicion nga shitja e prodhimeve për të përgatitur një fletëpalosje që u drejtohet prindërve dhe nxënësve.

Në përgjithësi, sistemi i arsimit në Kosovë sapo ka filluar të fokusohet në matjen e outputeve të tij. Megjithëse formula e aplikuar për financim në bazë të numrit të nxënësve paraqet një përmirësim sa i përket qështjeve të menaxhimit financiar, është e nevojshme që shkollat të motivohen për reduktimin e shkallës së mungesave të nxënësve dhe rritjen e nivelit pjesëmarrjes në arsim.

Zhvillimi personelit dhe metodologjia mësimore

Zhvillimi i personelit është një çështje tjetër me rëndësi për shkollat e mesme. Sipas rregullativave në fuqi që kanë të bëjnë mbi transferin e kompetencave për të menaxhuar me arsimin e mesëm. Bazuar në të dhënat nga intervistat me drejtorët, gati gjysma (47%) e stafit mësimor të gjimnazeve e kanë kaluar trajnimin fillestar për mësimdhënës. Kjo përqindje është dukshëm më e vogël për shkollat e mesme profesionale (sillet nga 17% në shkollat e mesme teknike deri në 30% në shkollat e mesme të bujqësisë). Megjithatë rreth 70% nga 100 mësimdhënës të shkollave të mesme të intervistuar shprehen se kanë kaluar nëpër ndonjë trajnim. Përveq kurseve të trajnimit fillestar, nuk ekzistojnë fonde për zhvillimin e personelit në shkollat e mesme. Rreth 1/3 e mësimdhënësve të intervistuar pranojnë të kenë edhe një punë shtesë përveq mësimdhënies. Në shumicën e rasteve puna shtesë nuk është fare e lidhur me punën që ata bëjnë në shkollë, megjithëse 20% të atyre që punojnë deklarojnë se mbajnë orë shtesë që pak a shumë është e lidhur me punën si mësimdhënës. Arsyeja kryesore për punën shtesë del të jenë pagat e ulëta si mësimdhënës (në 70% të rasteve), gjë që reflektohet në motivim të ulët gjatë punës në shkollë.

Duket që nevojat për trajnim të personelit të shkollave të mesme janë më shumë të natyrës pedagogjike se sa në ndonjë lëmi specifike të mësimin. Në mungesë të mjeteve të reja mësimore (teknologjia kompjuterike, laboratorët e kimisë, fizikës etj.), në procesin mësimor ende dominon shkumësi dhe dërrasa e zezë. Duke pasur parasur mungesën e mjeteve konkretizuese në procesin mësimor, ka një tendencë në insistimin nga mësimdhënësit që nxënësit të mësojnë vetëm konceptet teorike. Mungesa e këtyre mjeteve poashtu është e reflektuar në rolin dominant të mësimdhënësit gjatë procesit mësimor. Shumica e mësimdhënësve të intervistuar shprehen të gatshëm për të marrë pjesë në trajnime. Në fakt, trajnimin të mësimdhënësve i është dhënë prioritet më i lartë në listën e prioritetëve me qëllim të përmirësimit të procesit dhe strategjisë të aplikuar në mësimdhënie.

Tekstet mësimore dhe teknologjia kompjuterike

Procesi i reformave në arsimin e mesëm nuk është përcjellur me përgaditje të duhur të teksteve mësimore dhe teknologji kompjuterike. Rreth 50% e mësimdhënësve të intervistuar konsiderojnë se teksteve mësimore ekzistuese janë të dobëta ose të një cilësie të ulët. Ka shumë pak shembuj praktik për të ilustruar ndonjë problem më konkretisht, ndoshta për arsye se shumica e teksteve janë të përpiluara shumë herët. Kështu që është nevojë urgjente përgaditja e teksteve të reja apo ribotimi i atyre ekzistuese. Për më tepër, rreth 2/3 prej 20 shkollave sa kemi intervistuar nuk kanë bibliotekë. Kjo duket të jetë një pengesë e madhe posaqërisht për gjimnazet që pretendojnë t'i përgadisnin nxënësit për arsimin e lartë. Edhe në rastet kur biblioteka ekzistonte (në 1/3 e shkollave të intervistuar), fondi i librave është vlerësuar si i varfër nga mësimdhënësit.

Shumica e shkollave që janë vizituar kanë laborator të kompjuterëve, megjithëse numri i tyre për një shkollë është i vogël dhe ndryshon shumë nga shkolla në shkollë (shih tabelën më poshtë). Në disa shkolla ka rreth 228 nxënës për një kompjuter. Shumë pak shkolla kanë lidhje të internetit të instaluar dhe aq më pak e përdorin. Një nivel i tillë i teknologjisë informatike nuk siguron përmbushjen e nevojave elementare. Duke pasur parasysh rëndësinë e teknologjisë kompjuterike për zhvillimin e karrierës dhe për punësimin në të ardhmen, pajisja e shkollave me kompjuterë duhet të jetë prioritet në shpenzimet qeveritare/komunale në shkollat e mesme.

Tabela 12: Numri i nxënësve për një kompjuter

Lloji i shkollës	Numri mesatar i nxënësve për shkollë	Numri i kompjuterëve për shkollë	Numri i nxënësve për një kompjuter
Bujqësi	684	3	228
Ekonomi-Juridike	784	15	52
Gjimnaz	962	19	51
Teknike	1,071	9	119
Total	932	14	67

Procesi i marrjes së vendimeve dhe qështjet e buxhetit të shkollave

Në Ligjin mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm (LAFM) parashihet që shkollat duhet të kenë Bordin e tyre ku prindërit dhe përfaqësuesit e zgjedhur nga komuniteti lokal duhet të kenë votën e tyre. Asnjëra nga shkollat e mesme të përfshira në hulumtim nuk e kanë themeluar këtë Bord, megjithëse disa prej tyre thonë kanë përfaqësues të nxënësve në Bordin e Shkollës (ose në Këshillin e Shkollës siq quhet zakonisht) dhe se i konsultojnë prindërit me rastin e marrjes së vendimeve duke i ftuar ata në një mbledhje të hapur. Megjithatë këto mbledhje kanë më shumë karakter informativ dhe jo për marrjen e vendimeve. Duke u bazuar në rregullativat në fuqi që kanë të bëjnë me financimin, shkollat e mesme nuk kanë buxhet të vetin për ta përdorur për shpenzime të përditshme dhe për zhvillim të personelit. Komuna përmes Dejtoratit Komunal për Arsim është

përgjegjëse për alokimin e fondeve për shpenzime të shkollave përveq për paga. Me rastin e ndonjë shpenzimi të bërë nga shkollat, drejtori i shkollës duhet t'ia paraqes komunës dëftesën mbi shpenzimet e bëra deri në 100 €, ndërsa për shpenzime mbi këtë shumë duhet të merret leje paraprake. Megjithëse kjo procedurë si e tillë nuk konsiderohet të jetë joefikase, shumica e shkollave shprehen se kjo procedurë merr shumë kohë dhe se po krijohet një dozë të iritimit tek shkollat e mesme. Nga kjo fitohet përshtypja se mungesa e një autonomie më të madhe në shpenzimet buxhetore ka efekt negativ në cilësinë dhe motivimin e personelit menaxherial të shkollave. Për më tepër, në rastin kur marrëdhëniet me komunën nuk janë në nivelin e duhur këto probleme bëhen edhe më akute dhe mund të ndikojnë dukshëm në aftësinë e shkollave për të ofruar mësim cilësor.

Planprogramet (Kurrikulet)

Shumica e mësimit në të intervistuar shprehen se janë të familjarizuar (e njohin) kurrikulën në bazë të të cilës zhvillohet mësimi në SHM. Më shumë se ¾ e tyre mendojnë se ende ka nevojë të bëhen ndryshime në kurrikule gjë që mund të reflektojë qasjen e fragmentuar të ndjekur nga MASHT me rastin e reformimit të kurrikuleve. Në vend që të përgaditen kurrikulet për të gjitha klasat e arsimit të mesëm në mënyrë të integruar, MASHT për çdo fillim vitit përgadit kurrikulet për klasën përkatëse sipas sistemit të ri të arsimit.

Diferencat në suksesin e nxënësve sipas gjinisë dhe vendbanimit (urban-rural)

Bazuar në të dhënat që ekzistojnë shihet se ka ndryshime të konsiderueshme në pjesëmarrjen në arsimin e mesëm në mes të femrave dhe mashkujve dhe atyre nga vendbanimet urbane dhe rurale. Ndryshimi në pjesëmarrjen në edukim në mes të gjinive është në masë të konsiderueshme i ndikuar botëkuptimi mbi rolin tradicional të femrës në përkujdesjen për familjen. Ky rol i femrës në familje bashkë me martesat e tyre të hershme bëjnë që ato të mos e vijnë arsimin poaq sa mashkujt. Shumë pak shkolla të mesme kanë ndërmarrë hapa t' i zvogëluar këto diferenca, megjithëse sigurimi i transportit është aplikuar si masë për ta zbutur sadopak këtë problem dhe për të nxitur pjesëmarrje më të lartë në arsimin e mesëm të të rinjëve nga zonat rurale. Në anketat që janë zhvilluar në kuadër të këtij hulumtimi, janë bërë përpjekje që identifikohen diferenca në suksesin e nxënësve sipas gjinisë dhe vendbanimit. Shkollat e mesme pothuajse nuk mbajnë fare të dhëna mbi suksesin e nxënësve sipas gjinisë dhe vendbanimit. Megjithatë, nga 100 mësimit në të anketuar, 44% prej tyre mendojnë se ka ndryshime në suksesin e nxënësve që vijnë nga vendbanime urbane dhe të atyre nga vendbanime rurale, ku të parët (nxënësit nga vendbanime urbane) janë më të mirë. Në mesin e arsyeve për këtë ndryshim përmenden: shkollimi fillor më cilësor, niveli i arsimit të prindërve dhe kushtet ekonomike. Vetëm 1/3 e arsimtarëve të anketuar shprehen se ka diferenca në suksesin e nxënësve sipas gjinive, ku femrat mendohet se qëndrojnë më mirë.

Boksi 4: Projekti për Përmirësimin e Pjesëmarrjes në Arsim (EPIP)

Banka Botërore ka financuar një projekt prej 4.5 million US\$ duke synuar përmirësimin e pjesëmarrjes së fëmijëve dhe rezultateve të arsimit në shkollat fillore dhe të mesme. Projekti ka tri komponente: komponenti i grantit për zhvillimin e shkollës, i cili siguron fonde për shkollat për të përmirësuar pjesëmarrjen dhe rezultatet në mësim; komponenti për sistemin e menaxhimit të informacionit (EMIS) që ndihmon në fuqizimin dhe sigurimin e qëndrueshmërisë së sistemeve aktuale të informacionit (EMIS); dhe komponenti për menaxhimin e projektit që mbështet implementimin, monitorimin dhe vlerësimin e projektit.

Shkollat e përzgjedhura (në bazë të problemeve të dokumentuara dhe pjesëmarrjes dhe vijimit të rregullt të shkollë) përfitojnë ndihmë teknike dhe trajnime në fushën e planifikimit zhvillimor të shkollës, ndërsa granti mbulon edhe arrijtjen e rezultateve tek mbërritjen deri tek komuniteti, materiale edukative dhe aktivitete në ambjentin arsimor. Kontrolli i programeve të granteve të shkollave bëhet çdo vit. Sistemi i menaxhimit të informacionit (EMIS) do të fuqizohet, ndërkohë që në mënyrë të veçantë, EMIS ndihmon në monitorimin e regjistrimeve në shkollë, pjesëmarrjes, ndjekjes së shkollës apo braktisjes së shkollës dhe përfundimin e saj, përfshirë edhe përgjegjësitë për fëmijët që nuk marrin pjesë në sistemin shkollor në komunat e fokusuar. Për këtë qëllim është ofruar asistencë teknike dhe trajnime të jashtme si dhe janë financuar pajisje për zyrat e komunave dhe zyrat qendore.

Shkollat e mesme mund të aplikojnë për një shumë granti deri në 15,000 € me qëllim përmirësimin e rezultateve të nxënësve si dhe arrijtjen e pjesëmarrjes për grupet më pak të favorizuara. Projektet që aporvohen variojnë nga laborator kompjuterash tek sigurimi i furnizimit me ujë apo i një punëtorie/laboratory për auto-mekanik. Një element kyç në program është që ai zhvillon aftësitë e drejtorëve të shkollave në menaxhimin e projekteve dhe aftësitë vlerësuese të tyre.

3.2.3 Rezultatet e hulumtimit: Arsimi i Lartë

Në këtë pjesë janë prezentuar të rezultatet nga tri hulumtime:

- Anketa me 375 studentë të vitit të fundit të studimeve në Universitetit e Prishtës dhe me studentë të vitit të parë të studimeve në dy institucione private të arsimit të lartë (Universiteti Amerikan i Kosovës dhe Kolegji i Arteve dhe Shkencave Sociale),
- Anketa me 92 mpsimdhënës universiteti,
- Intervistat e thella me Dekanët e 8 Fakulteteve në kuadër të Universitetit të Prishtinës.

Vlerësime të përgjithshme

Fakultetet që janë në kuadër të Universitetit të Prishtinës (UP) nuk disponojnë me të dhëna për normën e diplomimit të studentëve të tyre, normën e përsëritjes së vitit dhe të atyre që i ndërprejnë studimet (ose së paku të dhënat ekzistuese nuk janë të përdorshme). Nga të dhënat që kemi marrë nga zyra qëndore e UP-së (Rektprati) del se nga rreth 23,000 studentë sa ka UP, në vitin 2001/2001 kanë diplomuar 2,375 studentë duke rezultuar në normë të ulët të diplomimit në rreth 10% (shih tabelën më poshtë).

Tabela 13: Të dhëna mbi numrin e të diplomuarve në Universitetin e Prishtinës (1970/71 deri 2001/2002)

Viti	Nr. i studentëve	Nr. i të diplomuarve			Nr. i të diplomuarve (%)			Norma e diplomimit
		Nga shkencat shoqërore	Nga shkencat teknike dhe të natyrës	Total	Nga shkencat shoqërore	Nga shkencat teknike dhe të natyrës	Total	
1970/71	10,386	232	55	287	0.81	0.19	1.00	0.028
1978/79	36,568	931	417	1,348	0.69	0.31	1.00	0.037
1989/90	25,091	1,248	859	2,107	0.59	0.41	1.00	0.084
2000/01	20,277	1,696	381	2,077	0.82	0.18	1.00	0.102
2001/02	23,175	1,887	488	2,375	0.79	0.21	1.00	0.102

Butimi: <http://www.uni-pr.edu/statistikat.html>

Nga 23,175 studentë sa kishte UP në vitin 2002/2003, 55% e tyre ishin të gjinisë mashkullore, megjithëse femrat përbëjnë shumicën e të diplomuarve. Rreth 60% të studentëve të intervistuar kanë mbaruar gjimnazin, por në disa Fakulteteve dhe Shkolla të Larta (SHL) të UP-së (si në Fakultetin e Mjekësisëm, Fakultetin Elektroteknik dhe të ngjashëm) shumica e studentëve kanë mbaruar shkollat e mesme profesionale përkatëse.

Nga 375 studentë të intervistuar, 33% janë nga zonat rurale që reflekton një strukturë të pavolitshme të participimit në arsimin e lartë të të rinjëve nga zonat rurale. Bazuar në shpërndarjen e popullsisë në Kosovë në zona urbane dhe rurale, kjo përqindje duhet të ishte dukshëm më e lartë.

Tabela 14: Vendbanimi permanent i studentëve të anketuar


Vendbanimi	Nr. i studentëve	%
Urban	249	0.66
Rural	124	0.33
Pa përgjigje	2	0.01
Total	375	1.00

Burimi: Anketa e Riinvestit me Studentë (Janar 2004)

Sa i përket personelit mësimdhënës në UP, mashkujt dominojnë me 79%. Struktura moshore e mësimdhënësve është paraqitur në figurën më poshtë. Rreth 62% të mësimdhënësve kanë të mbaruar doktoraturën, 33% kanë gradën e magjistratit të shkencave dhe 5% kanë ndonjë gradë tjetër.

Mësimdhënësit e gjinisë mashkullore qëndrojnë më mirë sa i përket këtyre gradave në krahasim me femrat. Përmirësimi i mëtejshëm i kurrikuleve në bazë të të cilave zhvillohet mësimi paraqitet si prioritet nga mësimdhënësit me rastin e rangimit të rekomandimeve të tyre për përmirësimin e mësimin në kuadër të UP-së.

Figura 2: Struktura moshore e mësimdhënësve universitar



Burimi: Anketa e Riinvestit me mësimdhënës universitar (Dhjetor 2003).

Megjithëse gati të gjitha Fakultetet dhe Shkollat e Larta (SHL) në kuadër të UP-së kanë bibliotekë, fondi i teksteve konsiderohet të jetë joadekuat si nga mësimdhënësit ashtu edhe nga studentët (këta të fundit vlerësojnë se fondi i bibliotekave me libra është i varfër). Të gjitha Fakultetet dhe SHL kanë mungesë të teknologjisë dhe pajisjeve kompjuterike. Në disa nga to, numri i kompjuterëve është shumë i vogël krahasuar me numrin e studentëve. Shumica e Fakulteteve kanë lidhje interneti, por duke pasur parasysh mungesën e kompjuterëve shumë pak studentë kanë qasje në internet nga Fakulteti.

Reformimi i kurrikuleve

Në anketën me studentë, të pyetur se si i vlerësojnë studimet sa i përket rëndësisë së tyre në tregun e punës për punësim (të matur me shkallën 1-5, ku 5=shkëlqyeshëm), vlerësimi mesatar i dhënë nga studentët ishte 2.88. Kështu që marrë në përgjithësi, studentët shprehin mendime të moderuara.

Për më tepër, 86% e studentëve të intervistuar shprehin se atyre nuk iu është dhënë ndonjë udhëzim nga Fakulteti apo Shkolla e Lartë (SHL) për mundësitë për punësim në të ardhmen. Studentëve poashtu nuk iu është ofruar udhëzim se si të përgaditet një CV, si të plotësohet një aplikacion për punë, ku të kërkohet për informatat lidhur me vendet e lira të punës di dhe njohuritë tjera bazë për të gjetur punë. Kjo që është duhet të trajtohet nga UP dhe se të gjitha Fakultetet dhe SHL-të duhet të ekzistoi shërbimi i udhëzimit për karrierë dhe për mundësitë për punësim.

Boksi 5: Zhvillimi i kurrikuleve për biznes dhe ekonomiks në Universitetin e Prishtinës (2001-2004)

Qëllimi i përgjithshëm i këtij projekti është që të ridizajnoi kurrikulet për Biznes dhe Ekonomiks në Universitetin e Prishtinës (në Fakultetin Ekonomik dhe në Shkollën e Biznesit në Pejë) dhe t'i bëjë këto kurrikule të krahasueshme me ato të Universiteteve të Unionit Evropian duke pasur gjithmonë parasysh Deklaratën e Bolonjës. Në këtë projekt janë të involvuar: Universiteti i Prishtinës, Universiteti i Stafordshirit, VAXJO UNIVERSITY, VRIJE UNIVERSITEIT BRUSSEL dhe UNIVERSITEIT VAN AMSTERDAM. Outputet e pritshme të këtij projekti janë: (i) kurrikulet e ridizajnuara për biznes dhe ekonomiks; (ii) përfundimi i Master’s Degree nga tetë studentë të studimeve pasuniversitare apo anëtarë të rinj të stafit në Kosovë në ndonjërin nga universitetet e cekura më lartë; (iii) pajisjet për një bibliotekë të re etj.

Kurrikulet në bazë të të cilave zhvillohet mësimi në UP janë aprovuar gjatë viteve 2000 dhe 2001. Mësimdhënësit në UP e shohin si nevojë urgjente ndryshimin/zhvillimin e mëtejshëm të këtyre kurrikuleve (84% e tyre mendojnë se ka nevojë për ndryshime shtesë të kurrikuleve). Megjithatë nuk është e qartë nëse mësimdhënësit mendojnë se këto kurrikule nuk janë të përshtatshme apo ata

vetë kanë nevojë për trajnim dhe përgaditje shtesë për aplikimin e këtyre kurrikuleve. Duke pasur parasysh kushtet nën të cilat UP ka operuar gjatë viteve të 1990-ta, atëherë mund të vlerësohet ekzistenca më e madhe e nevojës për përgaditje shtesë për mësimdhënës.

Metodologjia e mësimdhënies

Në përgjithësi mungojnë të dhënat për numrin e studentëve që përsërisin vitin dhe të atyre që nuk vijojnë mësimin me rregull apo edhe që e braktisin atë krejtësisht. Fakultetet dhe SHL nuk kanë të zhvilluar një sistem për mbledhjen e të dhënave për suksesin e studentëve. Bazuar në të dhënat nga anketa me mësimdhënës në UP, përqindja mesatare e studentëve që kanë përsëritur vitin akademik më 2002/2003 sillet nga 1.4% deri në 30% sipas Fakulteteve dhe SHL-ve. Ndërsa të dhënat nga anketa me studentë tregojnë se rreth 12% studentëve kanë përsëritur vitin shkollor së paku një herë. Fakultete dhe SHL-të nuk kanë bërë ndonjë përpjekje që të identifikojnë arsyet për këtë fenomen dhe aq më pak kanë ndërmarrë masa për ta zvogëluar atë. Rreth 50% e studentëve që kanë përsëritur vitin shprehen se arsyeja për përsëritje të vitit është se atyre iu është dashur që njëkohësisht krahas studimeve edhe të punojnë për t'i ndihmuar familjet e tyre. Përqindja e studentëve që nuk ndjekin ligjëratat me rregull sillet rreth 16%, por ka ndryshime të konsiderueshme në mes të Fakulteteve dhe SHL-ve dhe se nuk janë bërë përpjekje për përmirësimin e situatës në këtë aspekt. Megjithatë, duhet patur kujdes në interpretimin e këtyre të dhënave ngase ka të ngjarë që studentët më të mirë i përcjellin ligjëratat më me rregull, kështu që këta studentë kanë patur gjasa më të mëdha për tu përfshirë në mostër.

Të dhënat nga anketa me studentë tregojnë se rreth 51% e studentëve hyjnë së paku dy herë në një provim derisa ta kalojnë atë. Studentët mund të hyjnë disa herë në provim pa pasur frikë se mund të përjashtohen nga Universiteti për shkak të ngeljes/rënjes nga provimi për disa herë. Kjo dukuri ka efekt negativ duke zvogëluar motivimin e studentëve për të përcjellur ligjëratat me rregull dhe për të mbaruar provimet me kohë.

Në procesin e mësimdhënies në arsimin e lartë dominojnë metodat tradicionale të ligjërimit ngjashëm me gjendjen në arsimin e mesëm. Disa nga mësimdhënësit tani kanë filluar t'i përdorin projektorët dhe grafoskopët, por përdorimi i tyre i gjërë është i kufizuar për shkak të numrit të vogël të tyre në fakultete dhe SHL si dhe nga përdorimi ende i pamjaftueshëm i teknologjisë kompjuterike nga ana e mësimdhënësve. Mungesa e metodave bahkëkohore të ligjërimit poashtu reflektohet edhe në mënyrën e vjetëruar se si janë të organizuara ligjëratat, ku ligjëruesi/mësimdhënësi dominon dhe studentët janë shumë pak të inkurajuar që aktivisht të marrin pjesë.

Mësimdhënësit gjatë anketimit janë pyetur që të bëjnë rangimin e rekomandimeve të tyre sipas prioritetit sa i përket përmirësimit të strategjisë së mësimdhënies. Me këtë rast si prioritet ka dalë se ka nevojë për trajnim të mësimdhënësve në metodat e ligjërimit/mësimdhënies si dhe pajisshmëria më e mirë me teknologji të nevojshme për mësimdhënie. Nga kjo mund të konkludohet se mësimdhënësit në arsimin e lartë janë të vetëdijshëm për nevojën për trajnime në metodologjinë e mësimdhënies pavarësisht prej faktit se rreth 60% e atyre që janë intervistuar shprehen se kanë kalua nëpër ndonjë formë të trajnimit gjatë dy viteve të fundit.

Një çështje brengosëse në UP është fakti se nuk ka procedura/mekanizma për monitorimin e performansave të mësimdhënësve dhe mbajtjes me rregull të ligjëratave nga ana e tyre. Pasojë e kësaj është një situatë ku mësimdhënësit mungojnë (nuk i mbajnë ligjëratat) dhe nuk ndërmerr masa adekuate për këtë. Kjo gjendje mund të jetë edhe si pasojë e koncentrimin të madh të funksioneve menaxhuese në nivel të UP-së, ku kapaciteti menaxhes nuk e përballon përmasën e problemeve dhe madhësinë e këtij fenomeni.

Gjendja me tekste mësimore (literaturë) dhe me teknologji kompjuterike në UP

Pothuajse të gjitha Fakultetet dhe SHL-të në kuadër të UP-së kanë bibliotekë, por këto biblioteka nuk janë të pajisura si duhet me literaturë për studim. Në përgjithësi, rreth gjysma e mësimdhënësve të anketuar vlerësojnë se disponueshmëria me literaturë është e mirë, ndërsa opinionet e studentëve në lidhje me këtë qështje janë më negative se sa të mësimdhënësve.

Tabela 15: Opinonet e mësimdhënësve dhe studentëve në lidhje me disponueshmërinë me literaturë

Vlerësimi i gjendjes me literaturë	Opinionet e mësimdhënësve	Opinionet e studentëve
1. Shumë e mirë	0.10	0.10
2. E mirë	0.50	0.38
3. Disi	0.22	0.13
4. E keqe	0.11	0.33
5. Shumë e keqe	0.08	0.06
Total	1.00	1.00

Në pyetjen se a janë librat të lehta për tu mësuar, 63% e mësimdhënësve përgjigjen pozitivisht derisa vetëm 31% e studentëve e ndajnë këtë mendim. Megjithatë, kur janë pyetur se a ka mjaft shembuj praktike, studime rasti dhe ilustrime në librat që përdoren, vetëm 39% e mësimdhënësve dhe 25% e studentëve janë përgjigjur pozitivisht. Rreth 50% e mësimdhënësve dhe studentëve të anketuar përkrahin idenë e përkthimit në shqip të literaturës së huaj për të mbushur zbrastësinë me literaturë për studim.

Të gjitha Fakultetet dhe SHL-të kanë laborator të kompjuterëve, megjithëse numri i kompjuterëve që kanë është në disproporcion të thellë me numrin e studentëve dhe nuk garantojnë aftësimin e tyre të nevojshëm për përdorim të teknologjisë infprmatike. Mesatarisht, në Universitetin e Prishtinës ka një kompjuter për 40 studentë. Është interesant fakti se rreth 50% të mësimdhënësve dhe 25% të studentëve nuk i kanë përdorur këta kompjuterë fare. Megjithëse shumica e Fakulteteve dhe SHL-ve kanë lidhje të internetit, përdorimi i tij është i kufizuar nga numri i vogël i kompjuterëve në disponim dhe se ka pak gjasa që interneti të përdoret si burim shtesë në mësimdhënie (si për të gjetur artikuj dhe informata të ndryshme etj.). Mësimdhënësit që e përdorin internetin mesatarisht kalojnë rreth 8 orë në javë duke e përdorur atë, ndërsa studentët kalojnë 5-6 orë në javë.

Zhvillimi i personelit mësimdhënës

Tanimë është opinion i pranuar nga shumica se mungesa e fondeve ka ndikim negativ në zhvillimin e personelit në kuadër të UP-së. Niveli i ulët të pagave po i diskurajon të rinjtë për tu inkuadruar në mësimdhënie në UP. Mesatarisht 1/3 e mësimdhënësve të anketuar pranojnë se kanë edhe një punë shtesë përveç mësimdhënies në Universitet. Kjo mesatare në disa fakultete është shumë më e lartë (në Fakultetin Ekonomik 45%, në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës 70% dhe në Fakultetin Elektroteknik 50%). Rreth 61% të atyre që pranojnë se kanë një punë shtesë shprehen se pagat e ulëta në UP janë arsyeja kryesore për këtë veprim të tyre. Shumica e tyre punojnë për qeverinë dhe për organizatat ndërkombëtare që operojnë në Kosovë. Shumica e Dekanëve që kemi intervistuar kanë shprehur brengosje për këtë qështje sepse një fenomen i tillë konsiderohet se ndikon në cilësinë e mësimdhënies posaqërisht në rastet kur puna shtesë nuk është e lidhur me punën si mësimdhënës (25% të atyre që kanë një punë shtesë shprehen se punë shtesë nuk është e lidhur me punën që bëjnë në UP).

Poashtu, shumica e Dekanëve që janë intervistuar shprehen se janë të brengosur lidhur me mundësitë për zhvillimin e personelit. Megjithëse mungesa e një qasje të qartë rreth kësaj qështje shihet edhe si pasojë e mungesës së fondeve për këtë qëllim. Ka disa shembuj të bashkëpunimit të

UP-së me Universitete të huaja, gjë që po ndihmon personelin mësimdhënës në UP për tu zhvilluar profesionalisht në fushën e tyre përkatëse.

Nga intervistat me Dekanët, puna kërkimore në kuadër të UP-së është vlerësuar të jetë në nivel të ulët. Shumica prej tyre shprehen se pothuajse nuk ka fare punë shkencore (hulumtime) në kuadër të Fakulteteve që ata menaxhojnë dhe se kjo është duke ndikuar edhe në cilësinë e mësimin. Disa nga Dekanët e intervistuar shprehen se kjo është si pasojë e strukturës organizative që mbizotëron në UP, ku Fakultetet dhe SHL-të nuk kanë subjektivitet legal për të ndërmarrë ndonjë hulumtim. Fakultetet apo SHL-të nuk mund të mbajnë ndonjë pjesë të të hyrave që eventualisht mund të sigurohen përmes projekteve hulumtimeve, gjë që paraqitet si fakt dekurajues për të ndërmarrë ndonjë hulumtim në kuadër të Fakulteteve apo SHL-ve (më shumë për këtë qështje shih pjesën 2.3.3: Qeverisja dhe legjislacioni).

Cilësia e studimeve dhe gjasat për punësim të studentëve pas mbarimit të studimeve

Është vështirë të përcaktohet se në çfarë mase UP është duke i përgaditur studentët për tregun e punës. Arsyeja për këtë është se shkalla e punësimit të atyre që mbarojnë studimet, përveq nga cilësia dhe aktualiteti i studimeve në tregun e punës, varet edhe nga kushtet e përgjithshme ekonomike. Rreth 63% të studentëve të anketuar shprehen se në bazë të studimeve që po bëjnë jenë të përgaditur deri në një masë për të gjetur punë.

Afërisht 62% e studentëve që intervistuar shprehen se pas mbarimit të studimeve do të kërkojnë punë, ku një pjesë e tyre njëkohësisht do të vazhdojnë studimet pasdiplomike (33% janë shprehur se do të kërkojnë punë dhe një pjesë prej 29% shprehen se do të kërkojnë punë dhe vazhdojnë studimet pasdiplomike). Tendencë për të emigruar në mesin e studentëve pas mbarimit të studimeve sillet rreth 10%. Kur janë pyetur për arsyet për këtë veprim (emigrim), shumica e tyre janë shprehur se do veprojnë kështu për shkak të gjasave më të mëdha për të gjetur punë dhe pagave më të mira. Kjo tendencë për të emigruar në mesin e personave me arsimim të lartë është konsistente me rezultatet e hulumtimit të kryer nga *Hoti dhe Adnett (2004)*, të cilët kanë përdorur të dhënat nga *Anketa e Riinvestit me Familje dhe me Tregun e Punës në Kosovë (Dhjetor 2002)*. Megjithatë çështja e migrimit të ekspertëve (brain drain) ende nuk është shumë akute në Kosovë, nëse nuk merren hapa të nevojshëm përmes politikave përkatëse si dhe në mungesë të mundësive për punësim në Kosovë ka shumë të ngjarë që ky fenomen të rritet në vitet e ardhshme.

Rreth 32% e studentëve të intervistuar konsiderojnë se shansat e tyre për punësim janë më të mëdha në sektorin privat. Sektorët tjerë, siq janë administrata, ndërmarrjet publike, sektori bankar etj. janë tërheqës por me një përqindje më të vogël se sa sektori privat. Vetëm 10% e studentëve të anketuar planifikojnë të hapin biznesin e tyre, që në njëfarë mase reflekton mungesën e shkathtësive për ndërmarrësi nga ana e studentëve, mungesën e kredive bankare për të themeluar biznesin si dhe kushtet e përgjithshme ekonomike.

Një qështje tjetër me rëndësi e që u theksua më parë është se studentëve nuk u ofrohen informata nga Fakultetet apo SHL-të për mundësitë për punësim pas diplomimit. Mungesa e udhëzimeve dhe këshillave për karrierë të mëtejme për studentë është mjaft e evidente në UP.

Shpenzimet private në arsimin e lartë

Në pjesën 2.3.2 (Shpenzimet qeveritare në arsim) janë prezentuar të dhëna mbi shpenzimet publike në arsim në Kosovë. Duhet ditur se shpenzimet e përgjithshme për arsim përbëhen nga shpenzimet private dhe publike. Për të fituar një pasqyrë të shpenzimeve private në arsim, në kuadër të anketës me studentë janë futur pyetje në lidhje me shpenzimet e tyre gjatë studimit.

Vetëm 19% e studentëve të anketuar shprehen se banojnë në konvikte¹³, ku qiraja e banimit është e subvencionuar nga qeveria. Pjesa tjetër e studentëve banojnë në sektorin privat ose me familjet e tyre dhe nëse janë jashtë qytetit udhëtojnë për çdo ditë për në Prishtinë. Rreth 20% e studentëve shprehen se kanë bursë për të mbuluar një pjesë të shpenzimeve të studimeve. Shpenzimet mesatare për student janë 213 € për muaj për mbulimin e shpenzimeve të përditshme, për literaturë, qira, udhëtim etj. Mirëpo devijimi standard i shpenzimeve mesatare për student është shumë i lartë për shkak se disa nga shpenzimet nuk llogariten si duhet posaqërisht në rastet kur studentët banojnë bashkë me familjet e tyre ose kur prindërit mbulojnë ndonjë shpenzim të tyre drejtpërdrejt. Nga anketimi i studentëve rezulton se rreth 45% e tyre shpenzonë prej 151 deri në 250 € për muaj, 20% shpenzojnë më shumë se 250 € për muaj kurse pjesa prej 35% shpenzojnë më pak se 151 € për muaj. Këto të dhëna mund të përdoren për të llogaritur pjesën e shpenzimeve private për arsim, posaqërisht në arsimin e lartë, gjë që është e rëndësishme me rastin e dizajnit të politikave dhe fondeve për arsimin.

Boksi 6: Institucionet private të arsimit të lartë:

Kolegji Arteve dhe i Shkencave Sociale

Kolegji Privat i Arteve dhe Shkencave Sociale është themeluar në tetor 2003. Megjithëse ende nuk është licencuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë ky kolegji zhvillon mësimin. Themeluesit e këtij kolegji kanë bërë përgaditjet që nga viti 1999., por kanë pritur derisa është aprovuar Ligji mbi Arsimin e Lartë. Ky kolegji ka dy departamente që ofrojnë studime të rregullta: atë të Shkencave Politike dhe të Ekonomiksit dhe ka gjithsej 60 studentë (nga 30 në secilin departament). Politika e kolegjit është që të angazhojë ligjërues të rinj që kanë studiuar jashtë dhe poashtu të zhvillojë bashkëpunim të mirë me kolegjet tjera. Megjithëse sipas Dekanit kolegji është i orientuar kah outputet për momentin nuk ka procedura të zhvilluara për të bërë këtë.

Boksi 7: Institucionet private të arsimit të lartë:

Universiteti Amerikan i Kosovës

Universiteti Amerikan i Kosovës (UAK) është themeluar si institucion privat i arsimit të lartë në Kosovë dhe është një nga universitetet e rralla në Evropën Juglindore që ofron arsimim të lartë diploma e të cilit njihet në SHBA dhe në Kosovë njëkohësisht. Ky universitet është themeluar si partneritet në mes të Fondacionit të Universitetit Amerikan në Kosovë (FUAK) dhe Institutit për Teknologji të Roçesterit (ITR). Ky i fundit është një universitet elitë në Amerikë i bazuar në Nju Jork. Programi i studimit është i fokusuar në ndërmarrësi dhe ndërmarrje të vogla dhe të mesme. Ky universitet punon sipas kurrikuleve të dizajnuara nga ITR dhe mësimdhënësit janë kryesisht nga Amerika. Universiteti është themeluar me ndihmën e mjeteve nga Fondi i Republikës së Kosovës, të grumbulluara nga shqiptarët në perëndim, me qëllim që të rinjëve në Kosovë tu ofrohen mundësi për arsimim ashtu që të kontribuojnë në zhvillimin shorëror, ekonomik dhe politik të Kosovës dhe të Evropës Juglindore. Universiteti ka 62 studentë dhe rreth gjysma e tyre kanë ndonjë lloj të asistencës financiare/bursë për të mbuluar pagesat e semestrit dhe shpenzimet tjera.

¹³ Sipas të dhënave nga zyra qendrore e studentëve në konvikte vetëm në Prishtinë banojnë 2250 studentë. Nuk kemi të dhëna për numrin e studentëve që banojnë në konvikte në qytetet tjera ku gjenen Shkollat e Larta që janë në kuadër të Universitetit të Prishtinës.

4. QËSHTJET KYQE NË FORCIMIN E ROLIT TË ARSIMIT NË ZHVILLIMIN EKONOMIK

Në këtë pjesë fillimisht janë identifikuar dhe janë diskutuar qështjet që kanë të bëjnë me qeverisjen dhe menaxhimin në arsim dhe nevoja për plotësimin e kornizës legislative. Në vazhdim janë diskutuar qështjet për përmirësimin e sistemit të matjes së outputeve të arsimit. Pastaj janë diskutuar metodat alternative për rritjen e shpenzimeve private në arsim dhe nevoja për decentralizim më të madh në procesin e vendim-marrjes. Vëmendje i kushtohet edhe forcimit të lidhjeve të sistemit të arsimit me tregun e punës dhe nevojës për zhvillimin e moduleve në të gjitha nivelet e sistemit të arsimit që kanë të bëjnë këshillime për karrierë. Në pjesën e fundit të këtij kapitulli është diskutuar procesi i reformave në arsimin e lartë. Në këtë pjesë në veqanti diskutohet roli i mekanizmave të ndryshëm për rritjen e konkurrencës në fushën e arsimit të lartë dhe nevoja për rritjen e pjesëmarrjes të të rinjëve në arsimin e lartë, rritjes së efikasitetit të punës dhe zhvillimit të kurrikuleve.

4.1 Qeverisja dhe legjislacioni

Në arsimin fillor dhe të mesëm Bordi Shkollës do të duhej të luajë rol më aktiv në mbikëqyrjen e punës së menaxhmentit të shkollës. Përfaqësuesit e zgjedhur nga prindërti dhe komuniteti lokal duhet ta kenë shumicën në këtë bord dhe gjithashtu në bord duhet të emërohen mësimdhënës nga shkollat tjera në atë lokalitet. Ky trup udhëheqë (pra Bordi i Shkollës) duhet të jetë përgjegjës për planin vjetor të shkollës dhe të përgadisë raportin vjetor i cili do iu shpërndahej prindërve të nxënësve dhe të tjerëve të interesuar.

Në arsimin e lartë egzistojnë një varg qështjesh që kërkojnë vëmendje të veçantë. Këtu përfshihen: marrëdhëniet në mes të MASHT-it dhe Universitetit të Prishtinës (pozita dhe roli i Senatit të Universitetit, përfaqësimi dhe roli në Senat i akterëve nga jashtë Universitetit dhe roli i Rektorit) dhe shkalla e autonomisë së Universitetit (duke përfshirë qështjet që kanë të bëjnë me caktimin, mbledhjen dhe menaxhimin e mjeteve nga participimi i studentëve). Poashtu është i rëndësishëm edhe zhvillimi i skemave të akreditimit (ku duhet të definohet se a duhet të bëhet akreditimi në nivel të Fakultetit, të programeve të studimit apo vetëm për institucion në tërësi –Universitetin), roli i Agjencisë për Akreditim të Kosovës dhe pavarësia e punës së saj nga MASHT, dhe zhvillimi i një agjencie për menaxhimin e fondeve për hulumtime në arsimin e lartë.

Legjislacioni aktual megjithëse siguron pavarësi akademike dhe universitare, ai nuk ka krijuar një mekanizëm në bazë të të cilit Universiteti dhe MASHT mund të punojnë së bashku në mënyrë efektive për të qar përpara zhvillimin e një universiteti modern. Në të njëjtën kohë duhet të dizajnohet dhe aplikohet një sistem më formal i kontraktimit (marrëveshjeve në mes të MASH-it dhe Universiteteve). Në këto kontrata duhet të specifikohet numri i studentëve të rinj që do të financohen nga MASHT-i si dhe shpërndarja e tyre nëpër fakultete të ndryshme. Niveli i participimit të studentëve duhet gjithashtu të përcaktohet si dhe të zhvillohet një formulë e financimit për studentë sipas programeve të studimit apo fakulteteve. Kjo formulë do duhet të aplikonte peshat specifike që do të reflektonin shpenzimet relative të studimit në secilin program (shih pjesën 4.7 më poshtë).

Decentralizimi i procesit të vendim-marrjes në Universitetin e Prishtinës do të krijonte më shumë fuqi kompetenca dhe përgjegjësi për fakultete gjë që do të reflektohej në ndryshimin e mënyrës së menaxhimit të tyre. Secili fakultet duhet të ketë trupin menaxhues të tij që, përveq dekanit dhe prodekanëve, do të përfshinte edhe përfaqësuesit e zgjedhur nga personeli akademik. Njësoj si shkollat e mesme, edhe Fakultetet duhet të përgadisnin një plan vjetor të zhvillimit strategjik të tyre

dhe një plan vjetor ku do raportohej mbi strategjitë dhe të arriturat në procesin mësimor, zhvillimin e kurrikuleve dhe qështjet që kanë të bëjnë me hulumtime.

Roli dhe puna e Agjencionit për Akreditim të Kosovës duhet të jenë të definuara qartë me qëllim që ruajtjes së kredibilitetit të programeve dhe diplomave në arsimin e lartë të Kosovës. Në veqanti duhet zhvilluar procedurat që kanë të bëjnë me standardet që një institucion i arsimit të lartë duhet të përmbush në mënyrë që të akreditohet. Eksperiencat nga vendet tjera nxjerrin në pah nevojë e përgaditjes së legjislacionit që do rregullonte mënyrën e alokimit të fondeve për hulumtime shkencore dhe legjislacionit mbi thirrjet akademike.

4.2 Matja e outputeve dhe menaxhimi i bazuar në performansa

Anketat e bëra në kuadër të këtij hulumtimi kanë treguar se institucionet e arsimit në Kosovë nuk kanë ndonjë traditë që në mënyrë sistematike të masin outputet e tyre. Sistemi i Menaxhimit të Arsimit që është zhvilluar në kuadër të MASHT-it ka zhvilluar një procedurë të regjistrimit e nxënësve sipas shkollave dhe të përcjellë pjesëmarrjen e tyre në arsim si dhe vijueshmërinë e rregullt. As MASHT-ti, as komonat dhe as vetë shkollat e mesme nuk kanë të dhëna për suksesin e nxënësve të tyre në provimet pranuese në universitet apo në suksesin në punësim pas mbarimit të shkollës. Poashtu edhe Universitetit nuk ka një sistem që do përcillte nivelin e punësimit të studentëve të diplomuar dhe as për matjen e përgjithshme të efektivitetit të strategjisë së mësimdhënies në nivel të moduleve, programeve apo fakultetit. Në përgjithësi, sistemi i arsimit në Kosovë është i orientuar kah inputet e jo nga outputet (rezultatet). Nuk ekziston një skemë motivuese për mësimdhënës dhe fakultete e shkolla të mesme për të rritur përpjekjet e tyre për të tërhequr më shumë nxënës dhe studentë me qëllim të rritjes së pjesëmarrjes në arsim dhe për të arritur performansa më të larta. Megjithëse aplikimi i një formule të financimit për nxënës/studentë paraqet një përmirësim në alokimin e fondeve, si shkollat e mesme ashtu edhe Universiteti duhet të nxiten që të reduktojnë mungesat/vijueshmërinë jo të rregullt në mësim/studime. Universiteti në veçanti duhet të nxitet që të reduktojë gjatësinë mesatare të studimeve. Këto qëllime mund të arrihen përmes një skeme motivuese të financimit në nivel të institucionit (fakultetit apo shkollës së mesme) dhe në nivel individual (për mësimdhënës). Për shembull reduktimi i gjatësisë mesatare të studimeve në arsimin e lartë do mund të bëhej përmes alokimint të fondeve në bazë të numrit të studentëve për tri vitet e para të studimeve të rregullta dhe duke mos financuar për studentët që përsërisin vitin. Kjo skemë motivuese duhet të shoqërohet me përmirësimin e standardeve të testimit/provimeve të studentëve, kontrollit dhe inspektionit të rregullt të cilësisë dhe pastaj përfshirja e gjithë kësaj në një sistem konsistent dhe efikas të menaxhimit të performansave.

4.3 Financimi

